



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Mars 2017



RES PUBLICA



KOMENTAR

i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

*...së bashku me një analizë të shkurtër krahasuese
të dy viteve të para të zbatimit të ligjit.*

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e National Endowment for Democracy.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e qendrës Res Publica dhe nuk reflekton opinionin e National Endowment for Democracy.

Grupi i punës për hartimin e këtij komentari përbëhet nga:

Dorian Matlija

Arbesa Kurti

Theodoros Alexandridis

Dr. Irena Dule

Botues: Qendra "Res Publica"

Redaktor: Dorian Matlija

Tirazhi: 200 kopje

Layout & Print: Expo Vision Albania

ISBN 978-9928-4337-3-2

KOMENTAR

i ligjit nr. 146/2014

“Për njoftimin dhe konsultimin publik”

...së bashku me një analizë të shkurtër krahasuese
të dy viteve të para të zbatimit të ligjit.

SHKURTIME

ADISA	Agjencia e Shërbimeve Publike të Integruara
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
KPA	Kodi i Procedurave Administrative
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
RENJK	Regjistri Elektronik i Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike
RTSH	Radiotelevizioni Shqiptar
SMS	Short Message Service (mesazh telefonik me tekst)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

TREGUESI I LËNDËS

(1/2)

7 **HYRJE**

9 **OBJEKTI, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET**

9 1. Të përgjithshme

12 2. Aktet ligjore që i nënshtrohen konsultimit publik

17 3. Parimet në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik

23 **DETYRIMI PËR NJOFTIM DHE KONSULTIM PUBLIK**

23 1. Mënyrat e njoftimit të projektakteve

25 2. Zhvillimi i konsultimeve publike

26 3. Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

31 4. “Publeaks.al” si një alternativë për konsultimin publik

33 **PALËT E PËRFSHIRA NË KONSULTIMIN PUBLIK**

33 1. Organet publike

26 2. Personat fizikë dhe juridikë

37 3. Koordinator i njoftimit dhe konsultimit publik

38 4. Të drejtat e palëve të interesuara

41 **RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT & KONSULTIMIT PUBLIK**

41 1. Mënyrat e njoftimit dhe të marrjes së komenteve/rekomandimeve

43 2. Njoftimet paraprake

43 3. Përmbytja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse

45 4. Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

47 5. Pjesëmarrja e palëve të interesuara në takimet publike

48 6. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve

49 7. Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

TREGUESI I LËNDËS

(2/2)

51 **KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E** 51 **ANKESAVE**

- 51 1. Shqyrtimi i ankimit nga titullari i organit përgjegjës
- 53 2. Shqyrtimi i ankimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe
Mbrotjtjes së të Dhënave Personale
- 55 3. Ankimi në gjykatë
- 57 4. Shembuj nga praktika. Çështje të ndjekura nga qendra Res Publica dhe
OJF të tjera për testimin e ligjit

63 **PROCEDURA TË VEÇANTA TË KONSULTIMIT PUBLIK**

- 63 1. Konsultimi publik për çështje mjedisore
- 76 2. Konsultimi publik i drafteve që ndodhen për shqyrtim në Kuvend

95 **ZBATIMI I LIGJIT NË PRAKTIKË. ANALIZË KRAHASIMORE**

- 95 1. Metodologjia
- 96 2. Autoritetet publike të monitoruara
- 96 3. Përfshirja e rubrikës për konsultimet publike në faqet e internetit të
autoriteteve publike
- 99 4. Koordinatorët për njoftimin dhe konsultimin publik
- 99 5. Regjistri për listën e projekteve për konsultim publik
- 100 6. Raste studimore nga vendimet e Komisionerit
- 101 7. Konkluzione të monitorimit
- 105 **LIGJI NR. 146/2014 “PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN**
PUBLIK” - TEKSTI I PLOTË
- 119 **VKM NR. 828, DATË 07.10.2015 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE**
TË KRIJIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT
ELEKTRONIK PËR NJOFTIMET DHE KONSULTIMET PUBLIKE”

HYRJE

Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik erdhi si pjesë e paketës së propozuar nga shoqëria civile për të përmbushur nevojën për një qeverisje më transparente dhe ndërmarrjen e politikave dhe nismave ligjore duke përfshirë edhe qytetarët e interesuar, OJF-të etj.

Procesi i konsultimit me publikun u ideua si një mundësi për një numër të madh personash dhe institucionesh që të kontribuojnë në përgatitjen e legjislacionit dhe që organet publike që hartojnë politikat të njiheshin me opinionet e subjekteve që prek ligji. Konsultimi e bën dialogun efektiv dhe përmirëson politikat dhe përmbajtjen e akteve ligjore. Përmes një shkallë më të lartë të konsultimit në procesin legjislativ rriten mundësitë që legjislacioni të pranohet më gjerësisht dhe të lehtësohet zbatimi i tij. Relacioni shoqëruar i këtij ligji thekson se qëllimi i nxitjes së vendimmarrjes së hapur, transparente dhe demokratike, realizohet përmes sigurimit të aksesit të lirë të qytetarëve në legjislacion, si dhe informimit gjerësisht mbi të.

Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik është miratuar në datën 30.10.2014 dhe ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2015. Ligji parashikon parimet, rregullat dhe procedurat e zhvillimit të konsultimit publik dhe pjesëmarrjes së publikut në proceset politikbërëse dhe vendimmarrëse. Ky ligj është në përputhje dhe me angazhimet që Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë në nismën globale “*Partneritet për qeverisje të hapur*”.

Në zbatim të ligjit është miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 828, datë 07.10.2015 *“Miratimi i Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrisë Elektronike për njoftimet dhe Konsultimet Publike”*, në të cilin, siç sugjerohet edhe nga titulli, parashikohen rregulla konkrete për funksionimin e regjistrisë për njoftimet dhe konsultimet publike.

Në këtë komentari synojmë të sjellim një analizë modeste të dispozitave të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe rregullave të parashikuara për ngritjen dhe mirëmbajtjen e Regjistrisë Elektronike për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Një kapitull i veçantë i dedikohet procedurave të veçanta të konsultimit publik si ato që zhvillohen për projektaktet dhe vendimmarrjen e organeve publike në çështjet mjedisore, apo konsultimin e drafteve që ndodhen për shqyrtim në Kuvend, të cilat janë jashtë fushës së zbatimit të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

OBJEKTI, QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

1. Të përgjithshme

Objekti i ligjit është rregullimi i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik për projektligje, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe politikave me interes të lartë publik (neni 1). Ligji parashikohen rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.

Duhet theksuar se ky ligj nuk është akti i vetëm që parashikon parimisht detyrimin e autoriteteve për të zhvilluar konsultimin publik, por ligjet e tjerë që parashikojnë raste të posaçme, nuk shprehen për mënyrat se si do të zhvillohet konsultimi publik. Pikërisht, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” kjo fushë është synuar të rregullohet, pavarësisht paqartësive që do t’i trajtojmë në vijim të këtij materiali.

Në parim, informimi dhe konsultimi publik ka 5 synime kryesore:

1. *Informimi*
2. *Konsultimi*
3. *Përfshirja*
4. *Bashkëpunimi*
5. *Fuqizimi*

Të pestë këto synime zbatohen në praktikë në dy këndvështrime të ndryshme: ai i publikut dhe ai i autoriteteve publike.

Në lidhje me synimin e parë, **informimin**, publiku kërkon të informohet për problematikën e trajtuar dhe të ndihmohet për të kuptuar alternativat e zgjidhjeve të ofruara përmes drafteve të propozuar. Nga ana e tyre, autoritetet publike duhet të përdorin të gjitha mjetet e arsyeshme për të informuar publikun. Informimi nuk përfshin vetëm vënien në dispozicion të draftit, por edhe shpjegimin e tij në një gjuhë të kuptueshme për publikun, duke e thjeshtuar përmbajtjen e draftit dhe zbërthyer atë në koncepte të thjeshta.

Në lidhje me synimin e dytë, **konsultimin**, publiku kërkon të merren mendime dhe rekomandime prej tij për alternativat që shtrohen për vendimmarrje. Autoritetet publike, pasi kanë realizuar me sukses informimin e publikut, duhet të dëgjojnë/lexojnë rekomandimet dhe shqetësimet e ngritura nga publiku. Nuk është patjetër e detyrueshme që rekomandimet të jenë në përputhje me draftin e propozuar. Prurja e publikut mund të jetë edhe në formë shqetësimi, i cili kërkohet të adresohet në draft në një mënyrë sa më efektive.

Në lidhje me synimin e tretë, **përfshirjen**, publiku kërkon që të punohet ngushtë me të gjatë gjithë procesit konsultativ/vendimmarrës, në mënyrë që të sigurohet që aspiratat dhe shqetësimet e publikut të merren në konsideratë. Nga ana e tyre, autoritetet publike duhet të sigurojnë publikun që këto rekomandime dhe shqetësime u dëgjuan me vëmendje dhe që u adresuan në mënyrë të përshtatshme.

Në lidhje me synimin e katërt, **bashkëpunimin**, publiku kërkon të jetë bashkëpunëtor me autoritetet publike në të gjithë aspektet e vendimmarrjes dhe autoritetet duhet t'i presin rekomandimet e publikut me seriozitet, sidomos kur ato janë të strukturuar mirë.

Në lidhje me synimin e pestë, **fuqizimin**, publiku pret natyrshëm që

të ndjejë fuqinë e vendimmarrjes. Publiku kërkon që të ketë sa më shumë në dorë për vendimmarrjen publike dhe autoritetet duhet të garantojnë se do të miratojnë propozimet e publikut, sidomos kur ato janë koherente dhe të studiuara mirë. Këtë funksion të fundit e realizon më së miri shoqëria civile e organizuar dhe e mbështetur financiarisht.

Fig. 1 - Diagrama e synimeve të ligjit për konsultimin publik

	Informimi	Konsultimi	Përfshirja	Bashkpunimi	Fuqizimi
Qëllimi i pjesëmarrjes publike	Të informohet publiku për problemet dhe të ndihmohet për të kuptuar alternativat e zgjidhjeve të ofruara	Të merren mendime dhe rekomandime nga publiku për alternativat që shtrihen për vendimmarrje	Të punohet ngushtë me publikun gjatë procesit, për të siguruar që aspiratat dhe shqetësimet e tij të merren parasysh	Të sigurohet partneritet me publikun në çdo aspekt të vendimmarrjes	Të kalohet vendimarrja sa më shumë në duart e publikut
Angazhimi i qeverisë për publikun	Do ju informojmë	Do ju informojmë, dëgjojmë rekomandimet dhe shqetësimet tuaja	Do ju sigurojmë që rekomandimet dhe shqetësimet tuaja do të merren para sysh	Do të presim rekomandimet dhe analizat tuaja të strukturuar në mënyrën më të mirë të mundshme	Do të miratojmë atë që ju do të vendosni

Në një mënyrë të përmbledhur, siç sugjerohet edhe nga emri, ligji parashikon dy faza të rëndësishme, *njoftimin* dhe *konsultimin*.

Njoftimi, sipas fazave, që do të trajtohen në vijim të këtij materiali, ndahet në njoftime paraprake, njoftime publike dhe dhënie informacioni në të gjitha fazat.

Konsultimi, siç do ta shpjegojmë në vijim, përfshin propozimet për nisjen e një konsultimi, dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve, si dhe takimet publike.

Fig. 2 - Diagrama e fazave të njoftimit dhe konsultimit publik



2. Aktet ligjore që i nënshtrohen konsultimit publik

Jo çdo akt i vendim marrjes publike i nënshtrohet konsultimit me publikun. Aktet që i nënshtrohen procedurave për njoftimin dhe konsultimin publik, sipas këtij ligji janë (neni 1, pika 1):

- Projektligjet (draftet e ligjeve që janë propozuar, përpara miratimit të tyre);
- Projekt-dokumenta strategjikë, duke përfshirë si ato kombëtare ashtu dhe ato vendore (draftet e dokumenteve strategjikë, të cilët përcaktojnë objektivat e politikave në një fushë të caktuar, si dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes një plani veprimi);
- Politikat me interes të lartë publik (Dokumente orientues të linjës politike që diktohet nga rrethana të caktuara, që do të ndiqet në një fushë të caktuar dhe që prek interesat e publikut në tërësi, p.sh. politikat penale orientojnë ligjvënësin dhe ligjzbatuesit në zbatimin e një mendësie të ndryshme për

ndëshkimin më të butë ose më të ashpër të një kategorie të caktuar të veprave penale, ose vendosin theksin në nevojën e zbatimit më të shpeshtë të dënimeve alternative).

Nuk i nënshtrohen konsultimit publik aktet e mëposhtëm (neni 4 pika c dhe ç):

- a) Akti administrativ;
- b) Akti nënligjor normativ;
- c) Akte normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave.

Në pikën e parë të akteve që përjashtohen nga konsultimi publik përmendet “akti administrativ”. Ky ndahet në dy kategori: *akti administrativ individual* dhe *akti administrativ normativ*. Ky i fundit është përmendur si pikë më vete, duke nënkuptuar se pika e parë flet vetëm për aktet administrative individuale. Por, ç’kuptojmë me këto terma?

- a) Me akt administrativ individual do të kuptojmë çdo vullnet të shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete (neni 2 pika 1). Për shembull, akti administrativ që emëron një punonjës (subjekt individualisht i përcaktueshëm), është një akt administrativ individual. E njëjta gjë vlen edhe për gjobat e vendosura, kontratat që lidhen për prokurimet publike, etj. Pra, çdo vendim (akt) administrativ që lidhet me interesat e një personi konkret (individ, shoqëri tregtare, organizatë jofitimprurëse, etj.) konsiderohet akt administrativ individual.
- b) Me akt administrativ normativ do të kuptojmë çdo vullnet të shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij

publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur *rregulla të përgjithshme sjelljeje* dhe që nuk shteron me zbatimin e tij (neni 2 pika 2). Kjo kategori përfshin ato akte administrative që nuk i drejtohen një individi apo personi juridik në veçanti, por që adreson probleme që i përkasin një grupi të gjerë. Për shembull një urdhër ministri që përcakton tarifat gjyqësore është akt administrativ normativ. Ky akt vlen për të gjithë ata persona që ngrenë padi në gjykatë dhe që duhet të paguajnë tarifat përkatëse të shërbimeve të administratës gjyqësore. Një shembull tjetër konkret është akti që përcakton cmimin e biletës së transportit urban. Edhe ky akt nuk i drejtohet ndonjë individi apo personi juridik të veçantë, por të gjithë personave që mund të shfrytëzojnë linjat e transportit urban. Edhe një tabelë rrugore që tregon drejtimin e detyruar është një akt administrativ normativ.

- c) Një kategori e veçantë e akteve normative është edhe “akti normative me fuqinë e ligjit” Përkufizimi për këto akte normative, që miratohen nga Këshilli i Ministrave, parashikohet në nenin 101 të Kushtetutës. Sipas këtij neni, Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve. Këto akte normative nuk janë akte administrative, por janë të barazvlefshëm me ligjet.

Sipas nenit 4, projektaktet të cilat nxirren nga Këshilli i Ministrave (pra draftet e Vendimeve të Këshillit të Ministrave), nuk i nënshtrohen konsultimit publik. Duhet të theksojmë që shpeshherë aktet normative, në rastin konkret Vendimet e Këshillit të Ministrave kanë një rëndësi të madhe dhe prekin interesat e qytetarëve njëjloj si edhe ligjet, por ligji i ka përjashtuar nga fusha e zbatimit të tij.

Sa më sipër janë përjashtimet që ligji parashikon sipas llojit të aktit. Por përjashtim bëjnë edhe disa raste të tjerë, sipas rrethanave. Kështu, ligji parashikohen këto rrethana përjashtimore:

- a) Kur akti trajton çështje të sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë *sekret shtetëror*, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- b) Kur bëhet fjalë për *marrëdhëniet ndërkombëtare* dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe me shtete të tjerë;
- c) Kur është situatë e *emergjencave civile* dhe projektakti lidhet ngushtësisht me masat që merren në kuadër të këtyre emergjencave;
- d) Kur trajtohen *çështje të tjera përjashtimore të parashikuara me ligj*. Me këtë parashikim të fundit, ndonëse ligji nuk parashikon raste të tjerë përjashtimore, ligjvënësi ka lënë hapësirë për të përfshirë edhe përjashtime të tjerë që mund të shprehen në të ardhmen ose mund të nënkuptohen nga interpretimi i organeve kompetente (si për shembull: autoritetet që hartojnë projektaktet ose Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në lidhje me pikën a), për të shqyrtuar nëse një projektakt prek sigurinë kombëtare duhet plotësuar kushti i domosdoshëm që çështjet të jenë klasifikuar “sekret shtetëror”. Në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, parashikohen procedurat e klasifikimit të informacioneve. Me “sekret shtetëror” kuptohet informacion i klasifikuar, ekspozimi i të cilit mund të rrezikojë pavarësinë, integritetin territorial, rendin kushtetues dhe marrëdhëniet me jashtë të Republikës së Shqipërisë. Gjithsesi, ekzistenca e këtyre rrethanave nuk sjell klasifikimin automatik si “sekret shtetëror”. Në këtë rast nevojitet që informacioni të jetë shpallur “sekret” nga organet kompetente sipas këtij ligji.

Pika b) më lart është vetëshpjeguese. Këtu përfshihet aktet që

miratojnë marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe që ratifikohen me ligj nga Kuvendi. Kështu, për shembull, një marrëveshje për të ndarë kufijtë detarë mes Shqipërisë dhe një shteti fqinj, nuk do të ishte objekt i njoftimit dhe konsultimit publik. Në këtë rast, marrëveshja do të trajtohej në rrugët diplomatike për të siguruar mbarëvajtjen e marrëdhënieve mes shteteve, për të cilat jo gjithmonë është e arsyeshme të ndahet informacioni me publikun dhe të merret një opinion paraprak nga publiku.

Një tjetër rast përjashtimor është edhe ai i akteve që nxirren në situatat e emergjencës civile. Konkretisht bëhet fjalë për situatat emergjente të shkaktuara nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, aktet terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin. Në këto raste organet ligjvënëse (Kuvendi, ose Këshilli i Ministrave në rastin e nxjerrjes së akteve normative me fuqinë e ligjit) duhet të veprojnë shpejt për të zvogëluar dëmet dhe për të rivendosur situatën nën kontroll. Dinamika e miratimit të këtyre akteve nuk lë hapësirë kohore për të ndërmarrë procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik.

Neni 4 i ligjit, nuk është shterues përse i përket listës së kufizimeve të zbatimit të ligjit, pasi pika d) i referohet rasteve të tjera që mund të parashikohen në ligje specifike, që do të thotë nëse një ligj i posaçëm parashikon ndalimin e konsultimit publik për çështje të caktuara, projektaktet në lidhje me këto çështje nuk i nënshtrohen zbatimit të ligjit për konsultimet publike. Kjo dispozitë është një *normë e bardhë* (blanket), e cila jo patjetër referon në një normë juridike (nen, pikë apo paragraph konkret), por mund të referojë parimisht në çdo dispozitë të mundshme që sot, ose në të ardhmen, në këtë ligj, ose në një ligj tjetër, shprehet për kufizimin e konsultimit publik.

Në pamje të parë kufizimet duken se janë shumë, por në praktikë akte të tillë që përjashtohen nga konsultimi publik janë të paktë, duke

mos minimizuar rolin e ndikimit të publikut në vendimmarrjen publike. I vetmi debat i vlefshëm që mbetet ende për t'u diskutuar është përfshirja e drafteve të vendimeve të Këshillit të Ministrave. Duhet thënë se në momentin që ligji për njoftimin dhe konsultimin publik ishte ende në fazën e draftit, aktet e Këshillit të Ministrave nuk përjashtoheshin. Ky ishte vullneti i asaj pjese të shoqërisë civile që u angazhua me hartimin e këtij ligji (kryesisht Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë). Por më pas, në Kuvend u pa me skepticizëm mundësia e konsultimit të këtyre drafteve për shkak të vështirësive që mund të vinin në praktikë, dhe kështu u vendos që ato të përjashtoheshin nga objekti i rregullimit të këtij ligji. Në të ardhmen, në varësi të angazhimit të shoqërisë civile dhe publikut në përgjithësi, do të jetë më i qartë raporti midis interesit dhe cilësisë së opinioneve të publikut nga njëra anë dhe ngadalësimit të procesit vendimmarrës nga ana tjetër, duke krijuar premisa të tjera që mund të bëhen shkak për ndryshimin e këtij ligji.

3. Parimet në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik

Si çdo ligj, edhe ligji për njoftimin dhe konsultimin publik udhëhiqet nga disa parime të cilët ndihmojnë zbatuesit e ligjit që ta interpretojnë atë më mirë në praktikë. Kështu, autoritetet publike gjatë procedurave të njoftimit dhe konsultimit të projektligjeve duhet të bazohen në parimet e mëposhtme:

a) Transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;

Siç lexohet nga pika e mësipërme (e marrë literalisht nga dispozita), ajo përmban disa parime brenda, që janë:

- Transparenca;
- Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse, dhe;
- Mosdiskriminimi në pjesëmarrje.

Transparenca gjatë procesit të konsultimit është një nga parimet e rëndësishme, i cili e vë autoritetin publik përpara detyrimit për të zhvilluar një procedurë të hapur të shqyrtimit të projektakteve, proceseve politikëbërëse dhe vendimmarrëse. Në zbatim të këtij parimi, autoriteti publik duhet të informojë në mënyrë efektive publikun. Për të arritur këtë nuk mjafton vetëm një njoftim në ambientet e autoritetit publik apo një shpallje në një kënd të fshehur të faqes së internetit. Njoftimi duhet bërë me mjete që garantojnë përhapje të gjerë të informacionit, si njoftimet në media, ose nëpërmjet postës elektronike në një regjistër të krijuar më parë nga autoriteti, ku të bëjnë pjesë organizata të njohura të shoqërisë civile që janë të angazhuara në fushën përkatëse që trajton projektakti.

Një aspekt tjetër që lidhet me transparencën është edhe plotësia e njoftimit. Një njoftim që bën të ditur nisjen e një procedure konsultimi nuk është i plotë nëse ai nuk shoqërohet edhe me aktet që janë në proces konsultimi.

Pjesëmarrja gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese duke se përmban dy koncepte që janë komplementare të njëra tjetrës por nuk është gjithmonë rasti të jenë kështu. Për shembull, një pjesëmarrje mund të mos jetë diskriminuese sepse në grupin e thirrur për konsultim mund të bëjnë pjesë individë nga grupe të ndryshme etnike, racore, gjinore, etj., por pjesëmarrja mund të jetë e kufizuar vetëm me individë të një lagjeje ose zone të qytetit, të cilët janë njoftuar paraprakisht të marrin pjesë në takim, ndërkohë që pjesa tjetër e qytetarëve mund të mos jenë në dijeni. Në këtë mënyrë pjesëmarrja nuk është gjithëpërfshirëse. Një dukuri i tillë ndodh kur, për shembull Bashkia Tiranë thërret një dëgjese publike për sheshin qendror të qytetit dhe siguron pjesëmarrjen e banorëve të njesisë nr. 5 duke shpërndarë SMS ose fletëpalosje derë më derë, ndërkohë që banorë të tjerë të kësaj njësie, si dhe banorët e njësive të tjera nuk kanë dijeni për dëgjесen publike. Nëse informimi bëhet pjesërisht atëherë kemi të bëjmë me shkeljen e parimit të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse.

Nga ana tjetër, parimi i pjesëmarrjes jodiskriminuese ka kuptimin që në pjesëmarrje nuk duhet përjashtuar askush, pavarësisht cilësive të veçanta të tyre. Për shembull, mund të jetë siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, duke njoftuar publikun e gjerë për seancën konsultative, por nuk është siguruar një vend i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara. Në këtë rast konkret, sigurisht që nuk është gjithnjë e pritshme prej autoriteteve publike që të mendojnë për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara sepse do të kërkonte burime të shumta, si për shembull interpretim audio të teksteve dhe grafikëve për personat që nuk shohin (ose shpërndarja e teksteve në alfabetin *Braille*), ose interpretues për personat që nuk dëgjojnë, etj., ndërkohë që mund të mos merrte pjesë asnjë person me aftësi të kufizuara të kësaj natyre. Në këto raste, është e pritshme që autoritetet publike të njoftohen në një kohë të arsyeshme për pjesëmarrjen e personave të veçantë me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të merren masat përkatëse. Në përgjithësi, aksesimi për personat me aftësi të kufizuara që përdorin mjete me rrota është plotësisht i mundshëm për t'u siguruar paraprakisht nga autoritetet edhe pa u njoftuar paraprakisht. Kështu, autoritetet publike mund t'i zhvillojnë takimet konsultative në ambiente të aksesueshme lehtësisht jo vetëm nga personat me aftësi të kufizuara por edhe nga persona të tjerë që për arsye moshe ose shëndetësore nuk kanë mundësinë të aksesojnë ambiente të tjerë.

b) Efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;

Që vendimmarrja e autoritetit publik dhe konsultimi publik në kuadër të kësaj vendimmarrjeje të jetë sa më efektive, procedura administrative duhet të zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë respektimin e të gjitha të drejtave që i njihen publikut dhe ky i fundit t'i ushtrojë këto të drejta në mënyrë efektive. Sigurisht që respektimi i afateve të vendosura nga ligji prevalon, me qëllim sigurimin e efijencës së procesit, por parimi i efektshmërisë detyron autoritetin

publik që të marrë masa që të nisje të procedurës që të ketë hapësirën e duhur kohore dhe kapacitetet e duhura njerëzore dhe logjistike që të përballojë një konsultim publik efektiv, pavarësisht nga përmasat e tij. Gjithashtu procedura duhet të zhvillohet me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm (neni 18 i KPA).

c) Përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara;

Përkufizimin se çfarë do të kuptojmë me përgjegjësi të organeve publike e gjejmë në nenin 15 të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin parashikohet se organet publike dhe nënpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës. Sigurisht që në rastin e konsultimit publik nuk është e lehtë të përcaktosh nëse ka ardhur një dëm dhe sa i kuantifikueshëm është ai, por parimi i përgjegjësisë lidhet edhe me sanksionet e parashikuara nga ligji për shkeljen e dispozitave të ligjit, pasi prezumohet që shkelja e dispozitave sjell dëm në interesin e publikut.

Përveç parimeve të mësipërme, të cilat janë parashikuar nga vetë ligji në nenin 5 të tij, për aq sa janë të zbatueshme duhet të respektohen dhe parimet e parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative, apo ligje të posaçme që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të ndryshme publike. Të tilla janë parimet e informimit, proporcionalitetit, dhënies së ndihmës aktive, objektivitetit, kontrollit, etj.

Disa prej këtyre parimeve janë të rëndësishme për konsultimin publik dhe gjejnë zbatim. Si për shembull:

1. Parimi i informimit

Ky parim garanton të drejtën e çdo personi të kërkojë informacion

publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit. Ky parim parashikohet në nenin 6 të KPA, si dhe rregullohet në mënyrë specifike nga ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Ky parim, si dhe kuadri ligjor që rregullon këtë fushë, shërben për të krijuar ide më të mirë rreth veprimtarisë së organit publik përpara se publiku të marrë pjesë në një konsultim publik. Për shembull, në konsultimin e draftit që lejon importin e mbetjeve në Shqipëri, personat që thirren në tryezën konsultuese nga publiku duhet të kenë informacion të saktë rreth menaxhimit të integruar të mbetjeve në vend, politikave që ka në plan qeveria për të ndërtuar një rrjet inceneratorësh, madhësia e tregut të riciklimit të mbetjeve të vendit, niveli i ndotjes në qytete të ndryshëm, etj. Pa siguruar këto informacione paraprake publiku nuk është i aftë për të dhënë opinione të vlefshme për draftin e propozuar dhe konsultimi publik do të dështonte.

2. Parimi i proporcionalitetit

Çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesa legjitimë, zhvillohet në përputhje me *parimin e proporcionalitetit* (neni 12 i Kodit të Procedurave Administrative). Në rastet e kufizimit të së drejtës për të marrë pjesë në konsultimin publik të një projektakti, organi publik duhet të balancojë arsyen e kufizimit të së drejtës me nevojën që e ka diktuar atë. Kështu, për shembull, Ministria e Drejtësisë mund të marrë nismën për një amnisti dhe kufizon konsultimin publik me arsyetimin se nuk ka kohë për ta zhvilluar atë sepse plani është që amnistia të miratohet në kuadër të festave të Nëntorit. Ky nuk është argument i vlefshëm për të kufizuar konsultimin publik, pasi nevoja e diktuar (miratimi i draftit për festa) nuk është një arsye e fortë për të kufizuar nevojën për konsultim. Drafti mund të miratohet edhe pas festave. Ndryshe është rasti kur për shkak të një situatë ku depot

e armatimeve janë hapur dhe armatimet janë vjedhur nga një numër i madh personash, Ministria e Drejtësisë apo Ministria e Punëve të Brendshme e sheh amnistinë si një mjet për të joshur qytetarët për të dorëzuar sa më shpejt armët pa pasur pasoja penale. Në këtë rast interesi publik mund të prevalojë ndaj interesit të konsultimit publik.

3. Parimi i dhënies së ndihmës aktive

Organi publik duhet të sigurojë që të gjitha palët e përfshira në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Për këtë arsye, organi publik duhet të informojë publikun mbi draftin që shtrohet për konsultim, duke përfshirë të gjithë informacionin që lidhet me të. Organi publik, që zhvillon procedurën e konsultimit, duhet të sigurohet që padija e publikut të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të grupimeve, prandaj për këtë arsye duhet të merren masa që informacioni të shpjegohet në terma sa më të thjeshtë dhe të kuptueshëm për publikun, për t'u bërë i kuptueshëm edhe nga persona me arsim të mesëm ose të ulët.

DETYRIMI PËR NJOFTIM DHE KONSULTIM PUBLIK

Në kreun II të ligjit parashikohen detyrimet që kanë organet publike në lidhje me zbatimin e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Në këtë kre janë parashikuar në mënyrë të përgjithshme detyrimet që kanë organet publike, ndërsa procedura specifike se si do të zhvillohen njoftimet dhe konsultimi publik është parashikuar në krerët në vazhdim.

1. Mënyrat e njoftimit të projektakteve

Çdo organ publik është i detyruar të marrë të gjitha masat që të krijojë mundësinë që qytetarët dhe palët e interesuara të marrin pjesë në procesin e konsultimit. Mënyrat për të realizuar pjesëmarrjen e të gjithëve qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e konsultimit publik, ligji i ka lënë në zgjedhjen e lirë të organeve publike (neni 6 pika 1).

Megjithatë, në ligj janë parashikuar dy mënyra, të cilat nuk janë përjashtuese, por plotësuese për informimin e publikut për projektatket dhe planet vjetore që janë në proces hartimi, si:

1. Për projektaktet, publikimi duhet të bëhet *në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike.*
2. Planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, duhet të publikohen *në programin e transparencës.*

Por, çdo të thotë “regjistër elektronik” dhe ku gjendet ai? Regjistri elektronik është një faqe interneti që shërben si bazë të dhënash dhe si vend për të afishuar draftet. Ky regjistër është përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave që të jetë: **www.konsultimipublik.gov.al**. Në vijim të këtij materiali flitet më gjerësisht për këtë regjistër.

Ndërkohë, termi “program transparency” sqarohet nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Sipas këtij ligji me “program transparency” do të kuptojmë tërësinë e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga ana e autoritetit publik, pa kërkesë nga publiku. Për ta shpjeguar më mirë, informacionet publike ndahen në dy lloje: ato që aksesohen pa pasur nevojë që të dërgohet një kërkesë me shkrim (ose me email); dhe ato që aksesohen vetëm nëse personi i interesuar paraqet kërkesë. Në kategorinë e parë bëjnë pjesë një sërë informacionesh që kërkohen shpesh dhe që kanë të bëjnë me strukturën organizative të institucionit, buxhetin, raportet e auditit, informacion për prokurimet publike, llojet e subvencioneve që ofrohen, oraret e punës dhe adresat e zyrave, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit, etj. Të gjitha këto informacione publikohen në një rubrikë të veçantë që duhet të gjendet në faqen e internetit të çdo institucioni dhe që duhet të organizohet në një formë që është miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit. E gjithë tërësia e këtyre informacioneve, në formatin e duhur, në rubrikën e duhur, quhet “program transparency” (neni 7 i ligjit nr. 119/2014). Një nga kategoritë e informacionit që duhet të përfshihet në programin e transparencës janë dhe *planet vjetore* që lidhen me procesin e vendimarrjes që i nënshtrohet konsultimit publik.

Disa nga mënyrat që institucionet publike mund të përdorin për njoftimin e projektakteve janë nëpërmjet afishimit në ambjentet e zyrave, informimit nëpër media audiovizive, gazeta, portale online, ose përmes dërgimit të projektakteve me email, etj. Autoritetet publike, si rregull, duhet të tregojnë kujdes, pasi duhet t'i ofrojnë mundësi të gjithë qytetarëve për të marrë pjesë në konsultimet publike, duke

pasur parasysh dhe aftësitë specifike të grupeve të veçanta të synuar. Për shembull, një projekakt që prek interesat e komunitetit rom nuk duhet të komunikohet thjesht online, por duhet të merren masa që të njoftohen organizatat dhe aktivistët e komunitetit.

2. Zhvillimi i konsultimeve publike (neni 6, pika 2)

Pas procedurës së njoftimit të projektakteve, organi publik ka të drejtë të organizojë takime publike me palët e interesuara. Siç konstatohet, ligji e ka lënë në zgjedhjen e organit publik organizimin ose jo të takimeve publike për konsultimin e projektakteve. Ligji nuk parashikon një mekanizëm detyrues për organin publik që të organizojë domosdoshmërisht një takim publik. Megjithatë, nëse nuk organizohet një takim publik, organi nuk shkarkohet nga detyrimi për të kryer konsultimin publik. Në këto raste konsultimi zhvillohet duke dorëzuar me shkrim opinionet dhe rekomandimet, nëpërmjet dorëzimit në zyrat e organit publik, me postë, ose me email.

Në kapitujt vijues do të analizojmë konkretisht edhe procedurën që ndjek organi publik për organizimin e takimeve konsultuese.

Ligji parashikon se në rastet kur është e mundur, takimet publike mund të transmetohen në median audiovizive publike, me qëllim që tryeza të ndiqet dhe nga publiku i gjerë. Në rastet kur në konsultim janë projektakte të rëndësishme, organi publik është i detyruar të transmetojë tryezën konsultuese, gjithsesi ky vendim merret nga vetë organi publik dhe me fjalë më të thjeshta është organi publik ai që vendos nëse një tryezë do të transmetohet në media apo jo. Në terma praktikë, transmetimi nuk varet vetëm nga vullneti i një autoriteti publik, por edhe nga mundësitë e medias publike për të qenë e pranishme me teknikën dhe personelin e duhur në ambientet e konsultimit, në datën dhe orën e caktuar. Sigurisht që autoriteti publik nuk mund të diktojë median publike (Radiotelevizionin

Shqiptar) që të transmetojë medoemos seancën konsultuese. Për këtë arsye, personat që kujdeset për aktivitetet e advokimit duhet të marrin parasysh edhe takimet me drejtues të medias publike përpara se të kërkojnë që një konsultim të transmetohet domosdoshmërisht.

Pavarësisht nëse tryeza transmetohet në media, organet publike duhet të mbajnë procesverbal për zhvillimin e takimeve të konsultimit publik. Procesverbali i takimit konsiderohet si dokument zyrtar, dhe ky dokument, bazuar në ligjin për të drejtën e informimit, mund t'i vihet në dispozicion qytetarëve apo personave që kanë interes për tu njohur me të. Ligji nuk e bën të qartë nëse ky procesverbal bën ose jo pjesë në atë kategori informacioni që duhet publikuar pa kërkesë në rubrikën “programi i transparencës”.

3. Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike (neni 7)

Regjistri elektronik është një faqe interneti (www.konsultimipublik.gov.al), e cila duhet të shërbejë si një pikë kontakti midis autoriteteve publike dhe publikut, në të cilën do të publikohen projektaktet që do t'i nënshtrohen konsultimit publik. Nga njëra anë regjistri shërben si një vend ku palët e interesuara mund të njihen me projektaktet që janë në konsultim dhe nga ana tjetër autoritetet mund të marrin komentet dhe rekomandimet nga palët e interesuara për projektaktet konkrete. Sistemi i faqes online është menduar si një platformë dinamike, e cila funksionon njëlloj si forumet online, ku çdo person i interesuar mund të lërë komentin e tij në kohë reale.

Duhet të theksojmë që autoritetet duhet të marrin masa që ky regjistër të garantojë aksesin në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, duke pasur parasysh dhe nevojat specifike për persona apo grupe të caktuara. Në praktikë kjo gjë nuk është aq e lehtë, pasi jo vetëm personat

me nevoja specifike mund të mos e aksesojnë dot faqen online, por edhe personat që për arsye të tjera nuk kanë akses në internet, ose nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të vepruar në brendësi të kësaj faqeje. Ligji nuk sqaron detaje, por e lë në kompetencën e Këshillit të Ministrave zgjidhjen teknike. Më konkretisht, përkujdesjen për këtë faqe e kryen Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, e cila disponon edhe njohuritë e duhura për të sjellë mundësitë më të fundit teknike në shërbim të një zgjidhjeje teknike sa më optimale.

Është pika 2 e nenit 7 që parashikon që rregullat për administrimin e regjistrit përcaktohen me akt nënligjor. Bazuar në këtë dispozitë, hyri në fuqi VKM nr. 828, datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave të krijimit dhe administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike”, në të cilin janë parashikuar konkretisht mënyrat e krijimit të regjistrit elektronik, rregullat se si funksionon, si menaxhohet etj.

Sipas VKM-së, përveç Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, mirëmbajtjen e faqes së internetit (regjistri elektronik) do ta bëjë edhe Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike do të mbikqyrë krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

Ndërsa bashkërendimi dhe rregullimi i të dhënave të Regjistrit Elektronik bëhet nga (AKSHI), i cili është një autoritet i krijuar me VKM nr. 703, datë 29.10.2014 “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”. AKSHI gjithashtu është përgjegjëse për hostimin e Regjistrit Elektronik dhe garanton funksionimin në mënyrë të vazhdueshme të tij, duke e mbrojtur faqen nga viruset dhe sulmet

e ndryshme kibernetike. AKSHI do të kryejë kopjimin rezervë të të dhënave (back-up) në mënyrë periodike.

Regjistri Elektronik do të përmbajë dy kategori të dhënash, në bazë të kohës dhe vendit të publikimit të projektaketve. Më konkretisht rregjistri do të përmbajë:

- a) Të dhëna parësore
- b) Të dhëna dytësore

a) Më të dhëna parësore do të kuptohen të gjitha njoftimet dhe projektaktet që publikohen për herë të parë në regjistrë si:

- të gjitha projekt-dokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik;
- të gjitha projektaktet, njoftimet për konsultim dhe të dhënat e lidhura me konsultimin e projekteve;
- planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes
- informacionet në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat

b) Me të dhëna dytësore do të kuptohen të gjitha ato projekte, të cilat janë të publikuara në fillim në faqen zyrtare të institucioneve, në bazë të ligjeve mbi të cilat organizohen dhe funksionojnë dhe më pas publikohen dhe në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike.

Kjo ndarje duket se është bërë për arsye praktike. Në kuptimin e ligjit nuk ka nevojë të bëhet një ndarje e tillë, pasi Regjistri Elektronik është një platformë e unifikuar e konsultimit publik. Por, meqënëse disa akte mund të jenë publikuar më parë në faqet e internetit të organeve publike dhe atje informacioni mund të pësojë ndryshime, ose mund të shtohen komente, Regjistri Elektronik kryesor e merr

informacionin nga një burim tjetër dhe kjo krijon mjaftueshëm arsye teknike për këtë ndarje.


Përveç informacioneve të mësipërme, Regjistri do të përfshijë dhe disa rubrika të tjera, në të cilat do të jepet informacion në lidhje me:

- Publikimin e projektaktit;
- Adresat për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij;
- Datën dhe vendin e organizimit të debateve publike;
- Informacion në lidhje me miratimin e aktit përfundimtar.

Të gjithë projektaktet që publikohen në Regjistrë duhet të jenë të plotë, të ndara në skedarë/dosje të veçanta.

Ato duhet të ruhen dhe të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të shkarkueshme nga personat e interesuar. Në çdo kohë personi i interesuar ka të drejtën e aksesit në këto dokumenta, ka të drejtën e printimit dhe të ripërdorimit të dokumentave.

Fig.3 - Faqja zyrtare e Regjistrit Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik



Momentalisht Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, siç shikohet dhe nga figura e mësipërme, është e ndarë në 4 rubrika. Një rubrikë është “konsultimi me qytetarët”, në të cilën publikohen projektaktet që i nënshtrohen konsultimit publik. Rubrika tjetër është “konsultime me ekspertët”, në të cilën mundësohet komunikimi në distancë me ekspertët që kanë punuar ose mbrojnë projektaktin. Në rubrikën “konsultime sipas institucioneve”, janë listuar institucionet e mundshëm. Për momentin janë përfshirë vetëm ministrinë, dhe nëse klikohet një institucion, listohen projektaktet që ky institucion ka në proces hartimi. Gjithashtu një nga rubrikat është “sondazhi”, ku për projektakte të ndryshëm shtrohen pyetje për publikun, me qëllim që të merret një mendim i përgjithshëm në lidhje me çështje të caktuara të projektaktit. Kjo e fundit është një rubrikë inteligjente sepse shpesh publiku nuk ka iniciativë të japë opinione të caktuara. Por, nëse pyetet, anëtarë të publikut janë të gatshëm të përgjigjen. Kjo metodë ngjan me “nxjerrjen e informacionit me grep” që përdoret shpesh në trajnime. Me anën e kësaj metode sigurohet opinioni i atyre individëve që për arsye të ndryshme janë pasivë, pavarësisht se janë të interesuar në procedurën e konsultimit.

Megjithëse VKM-ja ka hyrë në fuqi në Tetor të vitit 2015, Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nuk është ende funksional. Autoritetet publike vijojnë të mos e përdorin Regjistrin Elektronik dhe disa prej tyre i publikojnë projektaktet në faqet e tyre zyrtare. Në këto faqe, autoritetet kanë krijuar rubrika që trajtojnë konsultimet publike, ku në disa prej të cilave mund të gjenden dhe informacione në lidhje me kontaktet ku duhet të dërgohen rekomandimet/komentet, afatet brenda të cilave duhet të dërgohen etj. Megjithëse duhet të theksojmë që nga këto autoritete nuk zbatohen në mënyrë të plotë detyrimet që rrjedhin nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik.

4. “Publeaks.al” si një alternativë për konsultimin publik

Për arsye se Regjistri Elektronik nuk është ende funksional, qendra Res Publica ka çelur disa rubrika në funksion të konsultimit publik në portalin **www.publeaks.al**. Ky portal kryesisht është i dedikuar për të drejtën e informimit, por rubrikat “Projektligje në konsultim”, “Rekomandime për draftet” si dhe “Udhëzime për konsultimin” i dedikohen konsultimit publik.

Fig.4 - Faqja **www.publeaks.al**



Në këtë faqe, Res Publica ka publikuar draftet të ndryshëm që ndodhen në konsultim, të cilët janë mbledhur në faqet e ndryshme të internetit të autoriteteve publike. Personat e interesuar mund të shkarkojnë draftet dhe mund të postojnë në formën e komentit rekomandimet e tyre. Gjithashtu, Res Publica ofron edhe mundësinë që ide të ndryshme të papërpunuara të mund t'i përpunojë dhe dërgojë në formën e rekomandimeve të strukturuar autoriteteve publike. Për këtë të fundit mjafton që të kontaktohet qendra Res Publica në adresën e postës elektronike që është publikuar në këtë faqe.

PALËT E PËRFSHIRA NË KONSULTIMIN PUBLIK

Në nenin 8 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, janë parashikuar subjektet mbi të cilët shtrihen të drejtat dhe detyrimet që parashikon ky ligj. Subjektet e përfshirë në konsultimin publik, i klasifikojmë në bazë të llojit të tyre, detyrave, të drejtave dhe kompetencave që kanë.

Në lidhje me këto kritere, subjektet i klasifikojmë në dy kategori kryesore:

1. Organe publike
2. Individë dhe persona juridikë

1. Organet publike

Në ligj nuk specifikohet se cilat janë organet publike që kanë detyrimin për të zhvilluar procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik. Nëse i referohemi nenit 3, pika 6, të Kodit të Procedurave Administrative, me organe publike do të kuptojmë:

- a) Organet e pushtetit qendror;
- b) Organet e pushtetit vendor;
- c) Çdo organ i Forcave të Armatosura;

- d) Entet publike;
- e) Çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Në kuptim të ligjit për konsultimin publik, organ publik është çdo organ që nis procesin e hartimit të një projektligji, projekt-dokumenti strategjik, apo politike me interes të lartë publik. Nën petkun “organe publike” përfshihen disa institucione, por për të arritur në një analizë të drejtë, duhet të analizojmë se deri në çfarë mase detyrohen këto organe për të respektuar ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, pasi jo të gjithë institucionet kanë kompetenca për draftimin e akteve që i nënshtrohen konsultimit publik. Gjithsesi, ndarja në lloje nënkupton palët e procesit të konsultimit, që janë organet publike nga njëra anë dhe publiku nga ana tjetër.

Në ligj nuk janë parashikuar kufizime për autoritetet mbi të cilat nuk do të shtrihet zbatimi i ligjit, por bazuar në llojin e projektakteve që i nënshtrohen konsultimit publik, rezulton se disa institucione janë të përjashtuara nga detyrimet që rrjedhin nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Në nenin 81, pika 1, të Kushtetutës parashikohet:

Të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Minsitrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës.

Bazuar në ligjin për konsultimin publik, në harmonizim me dispozitën e mësipërme të Kushtetutës, konstatojmë që i vetmi subjekt që propozon akte është Këshilli i Ministrave. Mirëpo ky organ është kurora e një aparati më të madh që përfshin të gjitha ministratë dhe veprimtaria e tyre rregullohen me ligjin nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”. Çdo ministër ka detyrimin që projektligjet e hartuara t’i propozojë më pas në Këshillin e Ministrave dhe vetëm nëse aprovohen nga ky

organ kolegjal, projektligjet i propozohen Kuvendit. Projektligjet që hartohen nga ministritë, duhet t'i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Më pas, me dërgimin e draftit në Këshillin e Ministrave ligji nuk parashikon mundësi për pjesëmarrje në konsultim. Konsultimi publik në këtë fazë dhe në fazat e mëtejshme (diskutimet në Kuvend në komisione ose në seancë plenare) është i mbyllur.

Sa më sipër konstatojmë që projektligjet që propozohen nga deputetët dhe 20.000 mijë zgjedhës nuk i nënshtrohen konsultimit publik.

Ndërsa është e arsyeshme që projektligjet e propozuara nga zgjedhësit të mos i nënshtrohet konsultimit publik sepse ato vijnë nga vetë publiku, problematik mbetet fakti që projektligjet e propozuara nga deputetët nuk i nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Një tjetër element, që vihet re në praktikë është se komisionet e përhershme të Kuvendit, në të cilat ligjet shqyrtohen në parim, nën për nen dhe në tërësi, nuk i nënshtrohen konsultimit publik, pasi ato nuk janë organe publike në kuptim të ngushtë të ligjit, si dhe kjo fazë është e përjashtuar nga fusha e zbatimit të ligjit për konsultimin publik.

Megjithëse nëse i referohemi Rregullores së Kuvendit të Shipërisë parashikohet se:

- 1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim.*
- 2. Gjatë procesit legjislativ, komisioni mund të organizojë seanca*

dëgjimore publike, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore.

3. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarin dhe sekretarin e komisionit, i paraqet të ftuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.

Sa më sipër konstatojmë që Komisioni realizon seancë dëgjimore, kur e çmon të arsyeshme, duke ia lënë në diskrecion rast pas rasti anëtarëve të Komisionit për të vendosur nëse do të organizohen seanca dëgjimore. I vetmi rast kur Komisioni është i detyruar për të zhvilluar seancë dëgjimore është kur kjo kërkohet nga 1/3 e anëtarëve, të cilët duhet të motivojnë me shkrim arsyen pse duhet të zhvillohet seanca dëgjimore.

Megjithatë, Kuvendi ka zhvilluar një metodologji të adresimit të këtyre problemeve përmes publikimit të një *manuali* për konsultimin e drafteve në fazën që ato ndodhen për shqyrtim në Kuvend. Në vijim të këtij materiali është trajtuar edhe një kapitull i veçantë për këtë aspekt (shih faqet 76-93).

2. Personat fizikë dhe juridikë

Të drejtën për të marrë pjesë në njoftimin dhe konsultimin publik e kanë:

- a) Shtetasit e Republikës së Shqipërisë, ku përfshihet çdo shtetas shqiptar dhe çdo person juridik, i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar;
- b) Grupet e interesit, me të cilin kuptohet çdo organizatë që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.

Grupet e interesit mund të jenë të organizuar edhe përmes organizatave informale, të cilat janë krijuar si grupe *ad hoc* për një qëllim të veçantë nga vetë personat e interesuar. Në këtë rast, do të jetë më e vështirë që të ndiqen hapat e ankimit sipas ligjit, pasi një subjekt i paregjistruar nuk do të legjitimohej të paraqiste ankim. Ky problem zgjidhet përmes përfaqësimit të grupit të interesit nga një individ ose organizatë e regjistruar, e cila do të marrë përsipër edhe ankimin eventual;

- c) Personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë;
- d) Personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë. Për këta të fundit vlen edhe rregulli i “*zyrave të përfaqësimit*” sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe legjislacionit tatimor.

Personat e tjerë të huaj, mund të marrin pjesë në procesin e konsultimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ose me kërkesë të drejtpërdrejtë të organeve publike, kur e çmojnë të nevojshme.

Ndërsa personat e huaj të cilët kanë vendqendrimin në Shqipëri dhe personat pa shtetësi nuk kanë të drejtë të përfshihen në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.

3. Koordinator i për njoftimin dhe konsultimin publik (neni 10)

Bashkërendimi dhe administrimi i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik në çdo organ publik do bëhet nga një person përgjegjës, i cili do ketë statusin e *koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik*. Në nenin 10 të ligjit është parashikuar detyrimi i çdo organi publik për të caktuar një koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik, i cili do të garantojë procedurën e njoftimit dhe të konsultimit publik.

Në ligj është parashikuar vetëm detyrimi i organeve për të caktuar një koordinator, ndërsa detyrat dhe kompetencat e koordinatorit janë përcaktuar në VKM nr. 828, datë 07.10.2015.

Sipas VKM-së, koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik ka detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:

1. Është përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur të gjithë projektaktet e iniciuar nga të gjitha strukturat dhe departamentet e autoritetit përkatës;
2. Hedh projektligjet në formatin e duhur, në faqen e internetit;
3. Përditëson në mënyrë të vazhdueshme Regjistrin;
4. Kujdeset për zbatimin e afateve të parashikuara në ligj dhe në VKM.

VKM-ja parashikon se koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik duhet të pajiset me “emër përdoruesi” (username) dhe “fjalëkalim” (password) nga administratori i Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, i cili caktohet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Gjithashtu koordinatori duhet të pajiset me manualet për hedhjen e të dhënave në sistem, operimin, përdorimin e faqes së internetit, me qëllimin që të jetë i trajnuar për përdorimin e regjistrit dhe zbatimin në mënyrën e duhur të detyrimeve që rrjedhin nga ligji.

Për shkelje të ndryshme të ligjit, koordinatori është personi që mban përgjegjësi personalisht dhe ndaj tij zbatohen sanksionet që trajtohen në vijim. (shih faqet 54-55)

4. Të drejtat e palëve të interesuara (neni 9)

Qëllimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik është parashikimi

dhe garantimi i së drejtës së pjesëmarrjes së publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.

Në nenin 9 përcaktohen të drejtat që i njihen palëve që kanë interes për t'u përfshirë në konsultimin publik. Konkretisht njihen të drejtat e mëposhtme:

- a) E drejta për të kërkuar informacion në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik;*

E drejta për të kërkuar informacion është parashikuar dhe në ligjin për të drejtën e informimit, në të cilin përcaktohen procedurat për të kërkuar informacionin, afatet brenda të cilave një autoritet publik duhet të përgjigjet, rrugët administrative që ndiqen në rastet kur autoriteti publik refuzon të përgjigjet, etj.

Me qëllim që palët të kenë mundësi të kontribuojnë në mënyrë efektive dhe të mundshme në procesin e përgatitjes së aktit, organet publike kanë detyrimin të vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm. Gjithashtu, në varësi të kompleksitetit të projektaktit, personat e interesuar kanë të drejtë të marrin shpjegime për qëllimin, problemet që do të trajtohen, idetë e përgjithshme, studime, analiza etj. që janë kryer për hartimin e projektaktit. (neni 14)

- b) E drejta për të propozuar fillimin e procedurave për hartimin dhe miratimin e projektakteve të publikuara nga organet publike;*

Një nga pikat që përfshin njoftimi dhe konsultimi publik është dhe publikimi i planeve vjetore që lidhen me vendimmarrjen e autoritetit publik, të cilat duhet të publikohen te “programi i transparences”. Bazuar në planet vjetore, çdo subjekt ka të drejtë t'i propozojë autoritetit publik fillimin dhe miratimin e projektakteve, të cilat janë parashikuar në planin vjetor të organit publik.

Kjo e drejtë që është parashikuar në këtë nen është *blanket*, pasi në ligj nuk është parashikuar asnjë mekanizëm se si do të procedohet me propozimin, cilat janë detyrimet dhe procedurat që do të ndërmerren institucioni në lidhje me propozimin. Aktualisht në ligj mungon procedura që do të zhvillohet në rastin e propozimeve që vijnë nga publiku dhe ky është një nga problemet që duhet të adresohet me anën e një amendamenti.

c) E drejta për t'u vënë në dispozicion organeve publike rekomandime dhe komente për ato projektakte të cilat janë në proces njoftimi dhe konsultimi publik.

Pasi palët njihen me projektaktet, ato kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre në lidhje me projektaktin, duke marrë pjesë nëpër takimet publike (kur ato organizohen nga organi publik), ose duke dërguar komente dhe rekomandime tek organi publik që po përgatit projektaktin.

Duhet të theksojmë që të drejtat e mësipërme nuk janë absolute, ato i nënshtrohen kufizimeve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji, apo kufizimeve të parashikuara në ligje të posaçme.

Megjithatë, kufizimet duhet të jenë proporcionale me gjendjen që i ka diktuar dhe nuk duhet të cenojnë thelbin e së drejtës e pjesëmarrjes në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të organeve publike.

RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Më sipër analizuam në vija të përgjithshme detyrimet që kanë organet publike në lidhje me procedurën për njoftimin dhe konsultimin publik. Në këtë kre të ligjit parashikohen rregullat specifike të njoftimit dhe rregullat që duhet të ndjekin organet publike në realizimin e procesit të njoftimit publik.

1. Mënyrat e njoftimit dhe të marrjes së komenteve/rekomandimeve (neni 11)

Në nenin 11 të ligjit parashikohen mënyrat me anë të të cilave organi publik duhet të bëjë njoftimet për konsultimet publike. Siç është analizuar dhe më lart çdo organ publik duhet të publikojë projektaktin në Regjistrin Elektronik, duke i dhënë mundësinë çdo pale të njihet me të dhe të dërgojë komentet dhe rekomandimet.

Në pikën 1 të këtij neni parashikohen disa mënyra për realizimin e njoftimeve, të cilat mund të bëhen nëpërmjet:

- 1) Postës elektronike;
- 2) Afishimit të lajmërimit në ambientet e organit publik;
- 3) Lajmërimit në mediat audiovizive lokale, kombëtare ose rajonale;

- 4) Botimit në gazetatat lokale ose në të paktën në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.

Megjithëse ligji nuk shprehet konkretisht për *portalet online*, njoftimi në këto portale është gjithashtu një mënyrë e pranueshme për realizimin e njoftimeve, në përputhje me frymën e pikës së mësipërme.

Njoftimi nëpërmjet postës elektronike dhe afishimit të lajmërimit në ambientet e organit publik është një mënyrë e kufizuar e njoftimit, pasi njoftimi nëpërmjet postës elektronike i drejtohet një numri të caktuar personash, ndërsa njoftimi nëpërmjet afishimit në ambientet e organit, megjithëse parimisht i drejtohet publikut të gjerë, për arsye praktike, janë shumë të pakta mundësitë që personat të shkojnë çdo ditë në ambientet e organit publik dhe të rifreskojnë informacionin nëse ky organ po nis hartimin e një drafti të ri ose jo.

Megjithëse duhet të theksojmë që këto mënyra njoftimi janë komplementare me njoftimin që bëhet te Regjistri Elektronik dhe këto mënyra përdoren në ato raste kur organet publike e shikojnë të nevojshme të përdorin edhe këto metoda. Përveç tyre, në raste specifike, mund të përdoren dhe forma të tjera, sipas parashikimeve në ligjet e veçanta që rregullojnë funksionimin e tyre.

Publikimi i projektakteve në Regjistrin Elektronik, mënyra e publikimit të tyre sipas hierarkisë dhe fushës së veprimtarisë së organit publik rregullohet nga VKM nr. 828, datë 07.10.2015.

Në pikën 2 të nenit 11, parashikohet se e njëjta mënyrë zbatohet dhe për marrjen e komenteve dhe rekomandimeve për projektaktet. Bazuar dhe në VKM-në e dalë në zbatim të ligjit, në njoftim duhet të përcaktohet kontakti dhe adresa ku palët e interesuara të dërgojnë komentet dhe rekomandimet. Në rastet kur rekomandimet/komentet jepen gjatë tryezave publike, ato regjistrohen në procesverbale, të cilat janë publike për personat e interesuar dhe njëkohësisht vlejnë si provë e “*dorëzimit verbal*” të rekomandimeve.

2. Njoftimet paraprake (neni 12)

Më sipër u trajtua procesi dhe mënyra e njoftimit në rastet e zakonshme të zhvillimit të procedurave të konsultimit publik. Nenin 12 parashikon një procedurë të veçantë të zhvillimit të konsultimit publik, e cila bëhet përpara se organi publik të ketë hartuar projektaktin. Në raste të veçanta, kur organi publik e çmon të nevojshme, që përpara se të fillojë procedurat për hartimin e projektaktit kërkon të marrë opinione dhe rekomandime paraprake nga grupet e interesit. Organi publik njofton sipas mënyrave të parashikuara në nenin 11 planin për miratimin e aktit. Palët e interesuara kanë të drejtë të japin rekomandimet dhe komentet për aktin që është planifikuar për t'u hartuar.

Ky nen i ka lënë evazive rastet kur kjo procedurë do të ndiqet, duke u shprehur vetëm me termin “në raste të veçanta”, dhe duke ia lënë tërësisht në zgjedhje të lirë organeve publike vlerësimin rast pas rasti për ndjekjen e kësaj procedure.

3. Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse (neni 13)

Më sipër trajtuam mënyrat dhe procesin e njoftimit që duhet të realizojë organi publik për realizimin e konsultimit publik të projekteve. Në nenin 13 parashikohen disa nga elementet që duhet të përmbajë njoftimi. Këto elemente nuk janë ezauruese, por përfaqësojnë standardin minimal që duhet të përmbajë çdo njoftim për një projektakt që do t'i nënshtrohet konsultimit publik. Këta elementë janë:

a) Arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit

Përveç publikimit të projektaktit, organi publik është i detyruar që të

verë në dispozicion të publikut edhe relacionin shpjegues, me anë të të cilit organi publik shpjegon domosdoshmërinë e hartimit të këtij projektakti, qëllimin dhe fushën e zbatimit të tij, ndikimin që do ketë në rregullimin e një situate të caktuar, marrëdhëniet juridike që rregullon ose ndryshon, ndikimin në të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

b) Afati

Në njoftimin e projektaktit duhet të përcaktohet dhe afati, brenda të cilit palët e interesuara duhet të dërgojnë rekomandimet dhe/ose komentet e tyre. Në vijim të materialit do të trajtohen edhe afatet procedurale për secilën fazë të procesit të konsultimit publik. (faqet 45-46)

c) Mënyrën në të cilën palët e interesuara duhet të paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre

Përveç të tjerave, njoftimi duhet të përmbajë edhe mënyrën se si palët e interesuara duhet të dërgojnë rekomandimet/komentet. Në nenin 11 të ligjit është parashikuar se në të njëjtën mënyrë që bëhet njoftimi i projektaktit, do të bëhet edhe dërgimi i komenteve. Meqënëse llojet e njoftimeve mund të bëhen në disa mënyra, autoriteti publik duhet të përcaktojë qartë mënyrën se si do të marrë komentet, që mund të jetë me shkrim, online, ose nëpërmjet dëgjësave publike, etj.

d) Vendi ku do të paraqiten komentet/rekomandimet

Krahas afatit dhe mënyrës së marrjes së komenteve, në njoftim duhet të përcaktohet edhe vendi ku palët e interesuara duhet të dërgojnë komentet/rekomandimet. Duke qenë se çdo organ publik duhet të përcaktojë një person përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik, njoftimit duhet t'i bashkangjitet dhe informacioni në lidhje me emrin e personit përgjegjës dhe kontaktet e tij. Nëse koordinatori, ose një person tjetër kontakti nuk është caktuar, komentet/rekomandimet mund të dërgohen në adresë të titullarit të autoritetit përgjegjës.

Në rastet kur organi publik do të organizojë takime publike për diskutimin e projektaktit, njoftimit duhet t'i bashkangjitet informacioni në lidhje me vendin ku do të organizohet takimi, data dhe ora e saktë.

4. Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve (neni 15)

Në mënyrë që konsultimi të jetë efektiv, palët e interesuara duhet të kenë kohën e arsyeshme që të njihen me projektaktin dhe të hartojnë komentet dhe/ose rekomandimet përkatëse. Në nenin 15 ligji parashikon afate, brenda të cilave palët e interesuara duhet të dërgojnë rekomandimet e tyre. Këto afate janë të zakonshme, të cilat mund të zgjaten në rastet kur konsiderohet e rëndësishme dhe e domosdoshme nga organi publik.

Në varësi të fazës dhe llojit të konsultimit publik që do të zhvillohet, janë parashikuar dhe afatet kohore. Në pikën 1 të nenit 15 parashikohen afatet e përgjithshme:

- a) Në rastet kur organi publik ndjek procedurën e “njoftimit paraprak”, para se të fillojë hartimin e aktit, palët e interesuara duhet të dërgojnë brenda 20 ditëve rekomandimet dhe komentet. Afati është në ditë pune dhe fillon nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak.
- b) Edhe në rastin e njoftimeve për procesin e konsultimit publik për projektaktet afati është 20 ditë pune dhe fillon nga data e njoftimit të procesit të konsultimit publik.

Siç u shprehëm më lart, afatet janë të zakonshme, por me vendim të organit publik, afatet mund të shtyhen, sidomos kur aktet janë komplekse ose të rëndësishme. Në ligj është parashikuar që ky afat

mund të zgjatet deri në 40 ditë pune dhe afati fillon nga momenti i njoftimit të konsultimit publik. Në rast se organi publik vendos të shtyjë afatet, ai duhet të njoftojë palët e interesuara.

Gjithashtu, organi publik ka të drejtë të zgjasë afatin apo të përsërisë njoftimin kur komentet nuk janë cilësore, ose në rastet kur nga komentet kanë dalë çështje të reja të rëndësishme, që nuk kanë qenë të përfshira në draftin fillestar. Në këtë rast, ligji pothuajse ka garantuar një mekanizëm që e bën konsultimin publik më efektiv, duke dhënë më shumë mundësi që elementët e rinj të propozuar nga publiku t’i nënshtrohen një konsultimi të gjerë dhe t’i jepet mundësia edhe pjesës tjetër të publikut që të marrë pjesë në diskutimin e elementit/çështjes së re. Shprehemi “pothuajse” sepse ligji nuk e ka garantuar këtë aspekt me anën e detyrimit të organit publik, por vetëm duke i dhënë atij të drejtën të veprojë në këtë mënyrë. Nëse organi publik nuk e ushtron këtë të drejtë, konsultimi mbyllet brenda afateve të zakonshme.

Një afat specifik në lidhje me publikimin e projektaktit është parshikuar në VKM nr. 828, datë 07.10.2015, ku parashikohet se koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik duhet të publikojë projektaktin *brenda 48 orëve* nga momenti i miratimit të tij nga organi publik. Në rastet kur organi publik urdhëron që publikimi duhet të bëhet në një afat më të shkurtër, koordinatori e publikon projektaktin sipas afatit të urdhëruar. Ky afat prej 48 orësh, ose 2 ditë pune, nuk shtyn afatin e përgjithshëm të konsultimit, pasi afati nis nga momenti që organi publik ka marrë masa për publikimin e nismës me mënyrat e tjera që parashikon ligji. Për këtë arsye, Këshilli i Ministrave ka parashikuar një afat të shkurtër, në mënyrë që të mos humbasë kohë të vlefshme për publikun. Afati prej 48 orësh është mëse i arsyeshëm për të realizuar teknikisht hedhjen e materialeve përkatëse në Regjistrin Elektronik.

Në rastet kur ligjet e posaçme parashikojnë afate të ndryshme nga afatet e parashikuara në këtë ligj, sipas parimit *lex specialis derogat*

lex generalis (ligji i posaçëm ka përparësi ndaj ligjit të përgjithshëm), në këtë rast do të zbatohen afatet e parashikuara në ligjet e posaçme. Ndër ligjet e posaçme mund të përmendim Konventën e Aarhus-it, e cila është trajtuar në vijim të këtij materiali. (shih faqet 63-76)

5. Pjesmarrja e palëve të interesuara në takimet publike (nenet 17, 18)

Organi publik, në rastet kur e çmon të nevojshme dhe projekti ka një rëndësi të veçantë dhe ka një interes të lartë publik, përveç njoftimit të konsultimit publik, ai zhvillon dhe takime publike, ku marrin pjesë subjektet, grupet e interesit, ekspertët, OJF-të etj.

Në mënyrë që palët e interesuara të kenë kohë të përgatiten dhe të kenë mundësi të marrin pjesë në takim, organi publik duhet të bëjë njoftimin për takimin publik që do të zhvillohet, jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit.

Bashkë me njoftimin për afatin, njoftimit i bashkangjitet informacion për vendin, datën dhe orën kur do të zhvillohet takimi, si dhe një kopje e projektaktit që do t'i nënshtrohet konsultimit publik.

Takimet për konsultimin publik janë të hapura, ku çdo person i interesuar mund të marrë pjesë. Takimi drejtohet nga një përfaqësues i organit publik dhe organizohet sipas rregullave të organit publik. Pjesëmarrësit kanë të drejtën të shprehin opinionet në lidhje me projektaktin dhe çështjet që janë në diskutim, duke respektuar rradhën dhe etikën në komunikim.

Gjatë takimeve mbahet procesverbal, në të cilin regjistrohen pjesëmarrësit dhe diskutimet e gjithësecilit gjatë zhvillimit të takimit. Në praktikë mund të ndodhë që procesverbali të përfshijë vetëm

pjesë të diskutimit, duke e paraqitur atë të shkurtuar në mënyrë të përmbledhur. Për të pasur një dokument më të plotë të diskutimit, rekomandohet që takimi të regjistrohet me audio ose video dhe ky veprim nuk bie ndesh me ligjin.

Takimi mund të regjistrohet edhe nëse organi publik e konsideron të nevojshme. Në këto raste, organi publik mund të vendosë që takimi të transmetohet dhe në mediat audiovizive publike Radio Tirana, Televizion Shqiptar, kanalet e tjerë në platformën digitale të këtij institucioni, ose qendrat radiotelevizive lokale të RTSH). Ligji nuk parashikon transmetimin në mediat private, por një veprim i tillë nuk është i ndaluar. Nëse mediat private kanë interes, ato mund të transmetojnë takimin.

6. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve (neni 19)

Pasi palët e interesuara dërgojnë komentet/rekomandimet në mënyrën dhe adresën e përcaktuar nga organi publik, koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik mbledh të gjitha komentet dhe rekomandimet e dërguara nga palët e interesuara në mënyrë të strukturuar dhe transparente.

Pasi komentet/rekomandimet mbledhen bashkë, ato shyrtohen nga struktura përgjegjëse e organit publik. Pas shqyrtimit, organi publik vendos nëse rekomandimet do të pranohen ose jo, si dhe në çfarë mase do të pranohen. Në fund të procesit, organi publik harton një përmbledhje, në të cilën shprehet për rekomandimet/opinionet e marra në konsideratë dhe për arsyet pse rekomandimet e tjera nuk janë pranuar. Ky parim shtrihet njëllëj edhe në rastin e konsultimeve publike që zhvillohen në kuadër të ligjeve të tjerë, siç i trajtojmë në faqet 63-93 të këtij materiali.

Përmbledhja me arsyet e mospranimit i njoftohet palëve në një nga mënyrat e njoftimit të parashikuara në këtë ligj.

Në praktikë mund të ndodhë që numri i rekomandimeve të jetë tepër i lartë nga një numër i madh personash të interesuar. Për shembull, në rastin e drafteve në kuadër të reformës në drejtësi, numri i rekomandimeve për një nen të caktuar ishte mbi 5, të gjithë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Në këto raste organi publik mund të marrë kohë dhe të bëjë një përmbledhje për arsyet e mospranimit në grup të disa rekomandimeve. Ligji nuk parashikon që organi publik të përgjigjet ndaj çdo personi të interesuar, por vetëm të përgjigjet ndaj çdo rekomandimi. Në rastet kur rekomandimet janë të ngjashme në natyrë, pavarësisht ndryshimeve të vogla në modalitete, organi publik mund të japë një përgjigje të unifikuar. Më pas, i takon çdo personi të interesuar të identifikojë arsyet që përputhen me rekomandimet e dhëna nga vetë ai.

7. Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes (neni 20)

Krahas zhvillimit të procedurave të njoftimit dhe konsultimit publik, organet publike duhet të hartojnë dhe publikojnë raporte vjetore në lidhje me procesin e vendimmarrjes dhe politikëbërjes. Arsyeja pse në ligj është parashikuar hartimi dhe publikimi i raporteve vjetore është informimi i publikut në lidhje me transparencën e organeve në zhvillimin e proceseve të njoftimit dhe konsultimit publik.

Raporti vjetor duhet të përmbajë:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- d) numrin e takimeve publike të organizuara.

Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes është publik. Ai publikohet në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimin Publik, në faqen zyrtare të organit publik, ose në një nga mënyrat e tjera të parashikuara në nenin 11 të ligjit. Këto raporte janë një mjet shumë i mirë për të vlerësuar efektivitetin e konsultimit publik. Megjithatë, nuk përjashtohet mundësia që organet publike të përfshijnë në raport edhe rekomandime të ardhura prej organizatave konsulente të cilat teknikisht janë hartues të aktit dhe jo pjesë e publikut. Një tjetër element që mund të figurojë në raport mund të jetë edhe numri i takimeve publike të organizuara pa respektuar mënyrat dhe parimet e ligjit për njoftimin, duke thirrur vetëm persona të përzgjedhur për të kryer një konsultim fiktiv. Në këtë rast është detyrë e shoqërisë civile që të identifikojë dhe denoncojë rastet e konsultimeve fiktive.

SHQYRTIMI I ANKESAVE

Në kreun 5 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohen procedurat për shqyrtimin e ankesave të subjekteve të cilëve u janë cenuar të drejtat për t'u përfshirë në konsultimin publik. Në varësi të fazës në të cilën ndodhet projektakti, janë parashikuar dy institucione përgjegjëse për shqyrtimin e ankesave:

1. Titullari i organit përgjegjës dhe;
2. Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

1. Shqyrtimi i ankimit nga titullari i organit përgjegjës (neni 21, pika 1/a dhe 2)

Në rastet kur projektakti nuk është miratuar ende (me miratim kuptojmë momentin kur projektakti dërgohet për veprime të mëtejshme në Këshillin e Ministrave dhe jo momentin kur projektakti miratohet në Kuvend), ai është në proces hartimi nga organi publik kompetent dhe palëve të interesuara u janë cenuar të drejtat e parashikuara në këtë ligj, për shembull nuk janë njoftuar për procesin e konsultimit, ose nuk janë njoftuar për takimet publike të zhvilluara, ato kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ tek titullari i institucionit që është kujdesur për hartimin dhe konsultimin e draftit.

Në ligj nuk janë parashikuara afate, brenda të cilave pala e interesuar duhet të paraqesë ankimin administrativ tek titullari, por nga një interpretim i dispozitës rezulton që ankimi duhet të bëhet deri në momentin që akti nuk është miratuar nga organi publik dhe dërguar për veprime të mëtejshme në organin epror (për shembull Këshilli i Ministrave).

Në nenin 21 pika 2 e ligjit, parashikohen veprimet që ndërmerr titullari i organit publik:

“Organi publik përgjegjës, me marrjen e ankesës, merr masa të menjëhershme për korrigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura në ankesën e palës së interesuar. Në çdo rast, autoriteti publik njofton palën e interesuar për masat e marra dhe e fton të japë komentet dhe rekomandimet për projektaktin”

Sa më lart, konstatojmë që me marrjen e ankesës, titullari merr masa për reflektimin e vërejtjeve. Në këtë ligj nuk janë parashikuar procedurat se si do të shqyrtohet ankimi, për këtë arsye do t'i referohemi rregullimeve që bën Kodi i Procedurës Administrative (nenet 130-140), në lidhje me shqyrtimin e ankimeve, si dhe ligjeve organike që rregullojnë funksionimin dhe organizimin e organit publik përkatës.

Gjithashtu në ligj nuk parashikohet mënyra dhe përmbajtja që do të ketë ankimi administrativ. Referuar nenit 131 të Kodit të Procedurave Administrative, ankimi duhet të përmbajë:

- a) subjektin që ushtron ankimin, duke vendosur gjeneralitetet e personit që ankohet, adresën postare ose postën elektronike;
- b) organin që shqyrton ankimin, që në këtë rast do jetë organi publik kompetent që po harton projektaktin;
- c) objektin dhe shkaqet për të cilat bëhet ankimi. Këtu përfshihen

shpjegimet se ku konsistojnë shkeljet konkrete të organit publik në lidhje me zbatimin e procesit të konsultimit publik. Sipas nenit 21 palët mund të ankohen në rastet kur projektakti nuk është publikuar, nuk janë respektuar procedurat e njoftimit për procesin e konsultimit dhe/ose të takimeve publike, në rastin kur nuk janë respektuar afatet për zhvillimin e proceseve konsultuese etj.

Duke qenë se në ligj nuk është parashikuar as forma e paraqitjes së ankimit administrativ, referuar nenit 131 të KPA dhe elementeve që duhet të përmbajë ankimi, ai duhet të jetë në *formë të shkruar*, pra nuk mund të bëhet me gojë.

Pas shqyrtimit të ankesës së dërguar nga subjekti, dhe konstatimit të shkeljeve nga ana e organit publik për zhvillimin e procedurave të konsultimit publik, titullari merr masa të menjëhershme për korigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura nga pala e interesuar. Masat e marra i bëhen të ditura dhe palës ankuese (neni 21 pika 2).

Një element i rëndësishëm i dispozitës në fjalë është që palës së interesuar, të cilës i janë shkelur të drejtat, i jepet mundësia që të paraqesë rekomandimet e saj. Ky është edhe qëllimi kryesor i ankimit, që të mundësohet pjesëmarrja efektive në procesin e konsultimit.

2. Shqyrtimi i ankimit nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjen e të Dhënave Personale

Në rastet kur akti është miratuar dhe pala e interesuar konstaton që i janë cenuar të drejtat në lidhje me përfshirjen në procesin e konsultimit publik, ajo ka të drejtë t'i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit, i cili është institucioni përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve në këtë fazë.

Afati brenda të cilit pala duhet të dërgojë ankimin është 30 ditë kalendarike. Ky afat fillon nga dita kur është miratuar akti.

Edhe në këtë rast ankimi mund të dërgohet në rrugë postare ose nëpërmjet postës elektronike në adresë të Komsionerit për të Drejtën e Informimit dhe duhet të përmbajë gjeneralitetet e kërkesit, organin publik kundër të cilit bëhet ankesa, shpjegimin e arsyeve dhe shkaqeve të ankimit. Detajet e adresës merren nga faqja e internetit të Komisionerit www.idp.al.

Pasi Komsioneri merr ankimin, i kërkon palëve, si subjektit ankues ashtu edhe organit publik, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda një afati 10 ditor. Paraqitja e parashtrimeve me shkrim nuk është e detyrueshme, por rekomandohet të bëhet nëse ankesa nuk përmban informacion të mjaftueshëm.

Si rregull, Komisioneri i shqyrton ankesat në bazë dokumentash, pra pa zhvilluar seancë me palët, por në rastet kur Komisioneri çmon se është e nevojshme që të dëgjojë secilën nga palën organizon dhe një seancë dëgjimore, e cila është publike.

Në ligj nuk është parashikuar afati brenda të cilit Komisioneri duhet të shprehet mbi ankimin, si dhe nuk është parashikuar lloji i aktit administrativ që do të marrë Komisioneri në rastet e pranimit ose refuzimit të ankimit. Ligji parashikon se në rastet kur konstatohet që janë shkelur dispozitat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, Komisioneri i propozon organit publik kompetent marrjen e masave administrative kundrejt personave përgjegjës.

Komisioneri mund të marrë edhe vendim për mospranimin për shqyrtim të ankesës në rastet kur nuk janë respektuar kriteret formale, si për shembull: ankesa është dorëzuar jashtë afatit ligjor, ankimi nuk përmban informacion mbi gjeneralitetet apo kur është dërguar me postë nuk ka nënshkrimin e personit ankues, ose është tërësisht jashtë objektit të ligjit.

Llojet e masave dhe masat konkrete që merren në rastin kur shkelen dispozitat e ligjit për konsultimin publik, vendosen sipas parashikimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Nëse i referohemi ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, masat administrative që merren ndaj nëpunësve publik janë:

- a) vërejtje;
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;
- c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.
- ç) largim nga shërbimi civil.

Në këtë ligj janë parashikuar rregullat dhe procedurat që ndiqen për vendosjen e masës disiplinore dhe masën konkrete në proporcion dhe me shkeljen e kryer.

Në ndryshim nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i cili parashikon gjoba për koordinatorët e të drejtës për informim, ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk përmban sanksione me gjobë, por vetëm masat administrative të sipërpërmendura.

3. Ankimi në gjykatë

Në ligj nuk është parashikuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës në rastin kur titullari i organit publik ose Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk shprehen mbi ankimin ose refuzojnë ankimin e paraqitur.

Megjithëse në ligj nuk është parashikuar shprehimisht e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, në rastin kur shkelet e drejta për t’u përfshirë

në procesin e konsultimit publik, e drejta për t’iu drejtuar gjykatës për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat ligjorë është parashikuar parimisht në nenin 42 të Kushtetutës dhe më pas edhe në nenin 21/b të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjithashtu, nëse i referohemi nenit 7 dhe 15 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatës administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”, është parashikuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës kur subjekti pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga veprimi ose mosveprimi i organit publik.

Në lidhje me përcaktimin e afatit brenda të cilit mund të ngrihet padia për shkeljen e të drejtës për t’u përfshirë në procesin e konsultimit publik, duhet të analizojmë dy momente, pasi në ligj janë parashikuar dy afate, afati brenda 45 ditësh nga momenti i marrjes dijeni të aktit dhe afati 1 vjeçar.

Afati 45 ditor zbatohet vetëm në rastet kur akti administrativ që kundërshtohet parashikon të drejtën e ankimit në gjykatë dhe afatin brenda të cilit duhet t’i drejtohesh gjykatës. P.sh. vendimi i Komisionerit për të Drejtën e Informimit përmban një pikë në fund, e cila shprehet se personi ka të drejtën të ankohet në gjykatë brenda 45 ditëve.

Nëse nuk ka një akt (në rastin e mosveprimit), si dhe në rastin kur vendimi i refuzimit nuk përmban asgjë lidhur me të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës dhe afatin për këtë veprim, afati për të ngritur padi në gjykatë është 1 vit. Në rastin konkret duke qenë se ligji për konsultimin publik nuk ka parashikuar asnjë mekanizëm për llojin e aktit që do të marrë titullari i organit publik dhe/ose Komisioneri për të Drejtën e Informimit, afati për të ngritur padi në gjykatë presumohet në çdo rast të jetë 1 vit.

Problemi që konstatohet është në rastet kur akti është miratuar dhe

ka hyrë në fuqi. Ky vakuum ligjor sjell moszbatimin në mënyrë efektive të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik. Megjithatë, në rastet kur akti ka hyrë në fuqi, ai mund të kundërshtohet në Gjykatën Administrative të Apelit. Në këtë rast akti nuk kundërshtohet për mospjesëmarrjen efektive në konsultim, por për probleme që lidhen me shkeljen e të drejtave nga vetë përmbajtja e aktit.

Gjykata kompetente për shqyrtimin e padive do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e qarkut kur ka selinë organi publik që ka shkelur të drejtat e personit të interesuar. Për shembull, në rast se shkelja është bërë nga një ministri, gjykata kompetente do të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Shembuj nga praktika. Çështje të ndjekura nga qendra Res Publica dhe OJF të tjera për testimin e ligjit

Shembulli 1

Qendra “Res Publica” ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ankimin për mos njoftimin dhe publikimin e projektaktit “Për Amnistinë”.

Bazuar në ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ankuesi Qendra “Res Publica”, nëpërmjet kërkesës me nr.193/15 Prot, datë 09.12.2015 i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë për tu përfshirë në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik për draftin e Amnistisë.

Në përgjigje të kërkesës Ministria e Drejtësisë në rrugë elektronike në datë 18.12.2015, ka bërë më dije kërkuuesin se “Projektligji për amnistinë është miratuar nga Këshilli i Ministrave në datë 11.12.2015 dhe se projektakti po shqyrtohet nëpër komisionet parlamentare dhe për pasojë Qendra “Res Publica”, mund ti drejtohet kuvendit për të qene pjesë e konsultimeve publike nëse dëshiron”.

Pas marrjes së përgjigjes, për shkak se projektakti është njoftuar i miratuar, ankuesi ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit brenda afatit 30 ditë, në zbatim të nenit 21/1/b të ligjit nr.146/2016 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Në kushte të tilla ai legjitimohet për vijimin e shqyrtimit të këtij procesi.

Në shpjegimet e dhëna, ankuesi bën me dije se nga ana e Ministrisë së Drejtësisë nuk është përmbushur asnjë nga detyrimet e përcaktuara në ligjin e sipërcituar, pasi propozimi i projektligjit nuk është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë si dhe nuk është konsultuar me grupet e interesit, sipas parashikimeve të bëra në nenin 6 të ligjit.

Komisioneri në përputhje me nenin 3 të këtij ligji, “.. me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve. Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri organizon një seancë dëgjimore me pjesëmarrjen e palëve.

Në këto kushte, për të qenë sa më objektiv në shqyrtimin e rastit, Komisioneri vlerëson dhënien e parashtrimeve të organit publik, Ministrisë së Drejtësisë.

Parashtrimet duhet të pasqyrojnë përmbushjen nga ana e institucionit tuaj të detyrimeve të parashikuara në nenin 6 të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, lidhur me masat e marra për ti krijuar mundësinë e përfshirjes së publikut dhe të palëve të interesuara në njoftimin dhe konsultimin publik të projektaktit objekt ankimi, dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrjen e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, deri tek miratimi i aktit përfundimtar.

Parashtrimet duhet të evidentojnë nëse janë organizuar takime publike me palët e interesuara për të dhënë opinione lidhur me projektaktin, nëse është zbatuar afati i parashikuar në nenin 17 të ligjit për të vënë në dispozicion projektaktin për diskutim më parë takimit të organizuar, nëse i është dhënë koha e nevojshme sipas parashikimeve të bëra në nenin 15 për të paraqitur komente apo rekomandime për këtë projektligj, etj. Pra, në përgjithësi të parashtrihen fazat e ndjekura për hartimin e këtij projektakti në kuadër të njoftimit dhe konsultimit publik.

Në kushte të tilla, përpara përfundimit të shqyrtimit të ankesës për të konstatuar nëse ka apo jo shkelje të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me pikën 4 të nenit 21 të tij, Komisioneri kërkon të paraqitni me shkrim parashtrimet mbi këtë ankesë, brënda 10 ditëve nga marrja dijeni e kësaj kërkesë. (referojuni për këtë nenit 24/3 të ligjit 146/2014).

Në rast mosveprimi nga ana juaj brënda afatit të përcaktuar, Zyra e Komisionerit do të vlerësojë mbi ndjekjen e një seance dëgjimore.

Së fundi, tërheqim vëmendjen për të ndjekur dhe zbatuar detyrimet e kërkuara nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik, për caktimin e Koordinatorit sipas parashikimeve të nenit 10.

Shembulli 2

Nga verifikimet e kryera nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale rezulton se projektakti, “Për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, është depozituar në Kuvend nga nismëtari në datën 25.09.2015 dhe aktualisht është në fazën e diskutimeve në Komisionet përkatëse.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit, Nr.138. Prot., datë 05.02.2016, ndaj organit publik/Ministrit të Kulturës me objekt “Ankim për mosnjoftimin dhe publikimin e projektligjit për të Drejtat e Autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, lutemi referojuni në vijim ndjekjes së procedurës mbi trajtimin e saj.

Prej momentit të miratimit të tij, juve ju lind e drejta e depozitimit të ankimit në përputhje me nenin 21/1/b të ligjit nr.146/2016 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Pavarësisht kësaj, paraprakisht ju mund ti drejtoheni Ministrisë së Kulturës në cilësinë e organit hartues, Këshillit të Ministrave në cilësinë e organit propozues apo edhe Kuvendit për tu bërë pjesë e diskutimeve të projektligjit.

Në dy rastet e mësipërme konstatojmë që Komisioneri nuk ka marrë një vendim përfundimtar në lidhje me moszbatimin e detyrimeve ligjore nga ana e autoriteteve publike.

Në rastin e parë Komisioneri ka konstatuar që Res Publika legjitimohet të kërkojë pranë Komisionerit konstatimin e shkeljeve të kryera nga Ministria e Drejtësisë. Në këtë rast Komisioneri i ka kërkuar autoritetit publik parashtrimin e prapësimeve, por nga faktet që Res Publica disponon nuk rezulton që nga ana e Ministrisë të jetë dërguar ndonjë prapësim, si dhe Komisioneri nuk ka marrë ende asnjë vendim përfundimtar në lidhje me këtë rast.

Ndërsa në rastin e dytë, Komisioneri pavarësisht se konstaton që ligji ka kaluar nga institucioni pa iu nënshtruar konsultimit publik, mjaftohet vetëm me dhënien e rekomandimit për t’u përfshirë në pjesën e diskutimeve të projektligjit, i cili ndodhet në Komisionet përkatëse. Ky rekomandim nuk është efektiv për zbatimin e ligjit.

Shembulli 3

Shoqata “Intelektualët e Rinj, Shpresë” (I.R.SH) ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit me objekt “Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik për buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afat-mesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër”.

Në lidhje me këtë ankesë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit me vendimin nr. 54, datë 21.03.2017 është shprehur:

Konsultimi publik është një proces që duhet zbatuar në kuadër të transparencës, njohjes, konsultimit dhe edukimit ligjor nga të interesuarit, kategori e përcaktuar në këtë ligj. Në rastin konkret shpallja për konsultimin publik për Buxhetin e vitit 2017 dhe planin buxhetor afatmesëm 2018-2019 të Bashkisë Shkodër, për datën 24.01.2017, është bërë në datën 21.01.2017, ndërsa projekt buxheti 2017 është miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak me datë 30.01.2017. (sipas faqes zyrtare të Bashkisë Shkodër/depozituar e printuar nga ankuesi).

Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, në nenin 17 pika 2 parashikon afatet taksative të njoftimit për palët e interesuara të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike duke u dhënë kohën e nevojshme për përgatitje dhe vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet. (shih nenin 17 të ligjit 146/2014)

Ndjekja e procesit të bashkërendimit dhe administrimit të përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës për njoftimin dhe konsultimin publik, duhet/j bërë nga koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik i cili në kuptim të nenit 10 të ligjit është përgjegjës për këtë proces.

Pas konsultimit të ligjit, si dhe referuar parashtrimeve të organit publik në të cilat nuk provohet ndjekja dhe zbatimi i kërkesave dhe procedurave të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, Komisioneri ka arritur në përfundimin se procesi për konsultimin publik të projekt buxhetit nga organi publik është në kundërshtim me ligjin.

Shembulli 4

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (K.SH.H) ka paraqitur ankesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit me objekt “Ankim lidhur me cënimin e së drejtës për njoftim dhe konsultim publik për projektligjin “Për dhënie amnistie”.

Me vendimin nr.28, datë 13.02.2017, Komisioneri për të Drejtën e Informimit është shprehur se: Konsultimi publik është një proces që duhet zbatuar në kuadër të transparencës, njohjes, konsultimit dhe edukimit ligjor nga të interesuarit, kategori e përcaktuar në këtë ligj. Ligji nr.146/2014 në nenin 4 të tij, kufizon ndjekjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të një projektakti ligjor, nënligjor apo të një dokumenti strategjik të rëndësishëm.

Pas konsultimit të secilit kufizim të parashikuar në këtë dispozitë dhe përkufizimeve të specifikuara në to (si siguri kombëtare, akte administrative individuale, emergjencë civile etj, por dhe referuar parashtrimeve të organit publik në të cilat nuk argumentohet mbi këtë dispozitë, nuk rezulton që projektligji ti nënshtrohet përkufizimeve të kësaj dispozite. Në këto kushte konstatohet se procesi i konsultimit të projektligjit nga organi publik është bërë në kundërshtim me çfarë parashikon ligji për njoftimin dhe konsultimin publik. Gjithashtu sipas nenint 8 të ligjit, përkufizohet qartë kuptimi i i palëve të interesuara. Sipas kësaj dispozite ato janë: “organet publike, shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit..”.

Në kundërshtim me këtë dispozitë, organi publik pretendon të trajtojë vetëm përfituesit e këtij projektligji si grup interesi, duke përjashtuar kategoritë e tjera të këtij përkufizimi nga konsultimi i projektaktit.

Në bazë të konstatimeve të bëra dhe në mbështetje të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Komisioneri ka pranuar ankesën e bërë nga ana e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, si dhe marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës.

PROCEDURA TË VEÇANTA TË KONSULTIMIT PUBLIK

Përveç ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, në ligje dhe akte të tjerë nënligjorë mund të parashikohen procedura specifike për organizimin dhe zhvillimin e procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik. Në vijim po japim dy shembuj tipikë:

1. Konsultimi publik për çështje mjedisore

Një nga rastet është për aktet të cilat kanë për objekt çështje mjedisore. Konventa e Aarhusit (miratuar me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”) është një ndër mekanizmat kryesorë në fushën e mjedisit, e cila ka për qëllim të garantojë të drejtën e publikut për të marrë informacion në lidhje me çështjet mjedisore, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t’iu drejtuar gjykatës, në lidhje me çështje të mjedisit, kur nuk respektohen dy të drejtat e sipërpërmendura.

Pjesëmarrja e publikut në procedurën e hershme të marrjes së një vendimi për mjedisin duhet të realizohet me anë të lajmërimeve publike ose individuale dhe në një mënyrë të përshtatshme, efektive dhe në kohë, duke u informuar në lidhje me:

1. Veprimtarinë e propozuar dhe aplikimi mbi të cilin do të merret një vendim;
2. Natyrën e vendimeve të mundshme ose draftin e vendimit;
3. Autoritetin publik, përgjegjës për marrjen e vendimit;
4. Procedurën e parashikuar, mënyrën dhe kohën kur ky informacion mund të jepet, duke përfshirë:
 - a. fillimin e procedurave;
 - b. mundësitë e publikut për të marrë pjesë;
 - c. kohën dhe vendin e çdo takimi publik të parashikuar;
 - d. adresimin tek autoriteti publik, prej të cilit mund të merret informacioni përkatës dhe ku mund të depozitohet ky informacion për shqyrtim nga publiku;
 - e. adresimin tek autoriteti publik ose çdo organ tjetër zyrtar, të cilit mund t'i drejtohen komente ose pyetje, si edhe informimi për kohën ose afatet për paraqitjen e këtyre pyetjeve apo komenteve;
 - f. venien në dispozicion të informacionit të disponueshëm mjedisor në lidhje me veprimtarinë e propozuar si dhe faktin që veprimtaria i nënshtrohet një procedure kombëtare apo ndërkufitare të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Procedura e pjesëmarrjes së publikut duhet të realizohet brenda afateve të arsyeshme kohore, të cilat lejojnë kohë të mjaftueshme për publikun për të përgatitur dhe për të marrë pjesë në mënyrë efektive, gjatë marrjes së vendimeve për mjedisin.

Pjesëmarrja e publikut gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve që kanë lidhje me mjedisin duhet të bëhet brenda një kuadri transparent dhe të ndershëm, duke i siguruar atij informacionin e nevojshëm.

Përveç sa më sipër, shtetet kanë detyrimin që të sigurojnë pjesëmarrjen efektive të publikut në një periudhë të përshtatshme dhe gjatë përgatitjes prej autoriteteve publike të rregulloreve ekzekutive dhe

rregullave të tjera ligjore të përgjithshme e detyruese, të cilat mund të kenë një efekt të rëndësishëm në mjedis. Për këtë qëllim duhet të ndërmerren këto hapa:

1. Duhet të përcaktohen afatet kohore, të mjaftueshme për pjesëmarrje efektive;
2. Duhet të publikohen ose të bëhen të disponueshme për publikun, projektet e rregullave ligjore;
3. Duhet t'i jepet publikut mundësia për të komentuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore.

Gjithashtu ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 “Për mbrojtjen e mjedisit”, parashikon që gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike përkatëse sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në:

1. Procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit;
2. Hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit;
3. Hartimin dhe miratimin e rregulloreve e të akteve me karakter të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, vendimmarrjen për dhënien e lejeve përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin, të cilit ai i referohet.

Një nga aktet nënligjore, ku është parashikuar një procedurë specifike për zhvillimin e procedurës së zhvillimit të konsultimit publik është Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 247, datë 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin e publikut dhe përfshirjen e tij në vendimmarrjen për çështjet mjedisore. Gjithashtu me anë të këtij

vendimi synohet të rritet transparenca dhe përgjegjshmëria e autoriteteve publike, duke rritur rolin dhe pjesmarrjen e publikut.

Në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, procedurat për vlerësimin e ndikimit në mjedis ndahen në 2 kategori, në *procedura paraprake* dhe *procedura të thelluara*. Kjo ndarje bëhet në bazë të llojit të projektit që kërkon vlerësim të ndikimit në mjedis. Bazuar në këtë ndarje që bën ligji, VKM-ja parashikon procedura të ndryshme për zhvillimin e konsultimit publik për të dy llojet e procedurave. Më poshtë do të trajtohen të ndara të dy procedurat, pasi paraqesin dallime në llojin e konsultimit publik që zhvillohet.

1.1 Informimi i publikut gjatë procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Procedura paraprake e vlerësimit të ndikimit në mjedis, zhvillohet për projektet që janë listuar në *Shtojcën II* të ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis si projekte në fushën e bujqësisë, industrisë nxjerrëse, industrisë së energjisë, prodhimit dhe përpunimit të metaleve etj., çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, si dhe për projekte që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin, etj.

Për zhvillimin e procedurave të konsultimit publik për procedurat paraprake, organi publik kompetent është Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), e cila duhet të zbatojë disa hapa të cilat janë parashikuar në VKM.

Faza e parë – hapi i parë që ndërmerr AKM-ja është informimi i publikut për projektin/procedurën në zbatim dhe marrjen e mendimeve për këtë projekt. Brenda 5 ditëve nga momenti që AKM-ja merr një aplikim nga zhvilluesi (që mund të jetë një organ publik,

si për shembull bashki, apo person juridik privat, për shembull një shoqëri tregtare që ndërton një impiant teknologjik për përpunimin e naftës), duhet të publikojë në faqen e internetit informacion të plotë në lidhje me projektin. Informacioni i publikuar duhet të përmbajë:

- a) të dhënat për procedurën që do të ndiqet;
- b) afatin e marrjes së vendimit dhe të publikimit të tij;
- c) mënyrën sesi publiku mund të përfshihet në vendimarrje duke paraqitur mendimin e tij;
- d) afatin brenda të cilit mund të jepen këto mendime;
- e) mënyrën dhe afatin brenda së cilit mund të ushtrohet e drejta e ankimit ndaj vendimit.

Informacioni qendron i publikuar në faqen zyrtare për 20 ditë (kalendarike) rresht. Afati për të dhënë mendime mbi projektin është 20 ditë (kalendarike) nga momenti i publikimit.

Faza e dytë - pasi AKM-ja ka zhvilluar fazën e parë të informimit, duke i dhënë mundësinë publikut për t'u njohur dhe dhënë mendime për projektin dhe pas miratimit të vendimit ai publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë. Shpallja e vendimit bën të mundur që publiku apo palët e interesuara të informohen për vendimarrjen përfundimtare të Agjencisë në lidhje me projektin, duke i dhënë mundësinë palëve të interesuar të marrin dhe një kopje të vendimit.

Siç konstatohet, publikimet bëhen në faqet e internetit dhe publiku nuk pritet që të ketë vëmendjen e duhur për të kapur në kohë këto zhvillime. Për këtë arsye supozojmë që është detyrë parësore e organizatave që mbrojnë mjedisin, që të kujdesen për të monitoruar në mënyrë periodike faqet e internetit dhe të njoftojnë më pas pjesëtarë të tjerë të interesuar të publikut. Një zgjidhje tjetër që është në zgjedhje e lirë të autoritetit publik është informimi përmes postës elektronike. Në këtë rast duhet pasur kujdes sepse OJF-të mund të për zgjidhen nga autoriteti enkas për të realizuar një konsultim fiktiv.

1.2 Informimi, konsultimi dhe dëgjesa publike gjatë procedurës së thelluar të VNM-së

Procedura e thelluar për vlerësimin e ndikimit në mjedis zhvillohet për projektet e parashikuara në *Shtojcën I* të ligjit, si psh. projektet për rafineritë e naftës bruto, termocentrale, stacionet e energjisë bërthamore etj., si dhe në rastet kur AKM-ja parashikon nevojën e e zbatimit të procedurës së thelluar.

Përfshirja e publikut gjatë *procedurës së thelluar*, në ndryshim nga *procedura paraprake*, përmban më shumë faza, për shkak se projekti i propozuar nga zhvilluesi ndodhet tashmë në një stad më të avancuar. Informacioni dhe dokumentacioni i cili duhet t’i vendoset në dispozicion publikut është më i gjerë dhe rëndësia e pjesëmarrjes së tij në vendimmarrje është më e madhe.

Faza e parë – hapi i parë që ndërmerr AKM-ja është informimi i publikut për projektin e propozuar dhe marrjen e mendimit të tij, në lidhje me përcaktimin e çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, bashkë me sqarimet përkatëse për procedurën në zbatim;

Sikurse gjatë procedurës paraprake, edhe në këtë procedurë Agjencia Kombëtare e Mjedisit duhet që brenda 5 ditëve nga momenti që merr një kërkesë nga zhvilluesi, të japë një informacion të plotë në lidhje me projektin, duke e publikuar informacionin në faqen e saj zyrtare. Informacioni qendron i publikuar për 20 ditë rresht.

Konkretisht informacioni i publikuar nga AKM-ja duhet të përmbajë:

- a) Procedurën që do të ndiqet për informimin, konsultimin, si dhe mbi dëgjesat publike që do të zhvillohen për projektin deri në momentin e miratimit të Deklaratës Mjedisore;
- b) Mënyrën dhe procedurën që duhet të ndjekur nga publiku,

- grupet e interesuara apo OJF të ndryshme për të paraqitur mendimet e tyre;
- c) Afatin brenda të cilit duhet të paraqiten mendimet, i cili është 20 ditë;
 - d) Afatin brenda të cilit është parashikuar të miratohet Deklarata Mjedisore dhe të publikohet në faqen e internetit;
 - e) Mënyrën dhe afatin brenda së cilit mund të ushtrohet e drejta e ankimit për procedurën e zhvilluar.

Në rastet ku projekti i propozuar ka karakter kombëtar, AKM-ja i bën të ditur zhvilluesit të projektit që ka detyrimin të informojë dhe të garantojë pjesmarrjen e publikut. Një nga detyrimet që ka zhvilluesi është përfshirja e të gjithë njësive administrative vendore që preken nga projekti.

Faza e dytë – pas njoftimit dhe informimit në lidhje me projektin dhe marrjes së mendimeve nga palët e interesuara, AKM-ja publikon të gjithë komunikimin që ka bërë me zhvilluesin. Komunikimi i publikuar përmban çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar dhe mendimet dhe kërkesat që janë dhënë nga publiku. Me anë të kësaj procedure publikut synohet t'i garantohet e drejta për të ndjekur hap pas hapi procedurën e hartimit të projektit.

Faza e tretë – Përveç AKM-së, VKM-ja i shtrin efektet edhe mbi zhvilluesin e projekteve, i cili ka detyrimin të zhvillojë disa procedura në kuadër të konsultimit publik të projektit. Gjatë hartimit të raportit të thelluar, zhvilluesi ka detyrimin që të informojë publikun dhe të marrë prej tij mendimet në lidhje me projektin dhe ndikimet që ai mund të ketë në mjedis. Mendimet e publikut dhe kërkesat, nëse ka, duhet të merren parasysh në momentin e hartimit të raportit të thelluar të VNM-së.

Zhvilluesi ka detyrimin që të informojë publikun mbi projektaktin

që do të realizojë. Realizimi i njoftimit të publikut mund të bëhet në disa mënyra, konkretisht përmes:

1. Publikimit të informacionit të plotë për projektin, duke e ekspozuar në zyrën e njësisë së qeverisjes vendore ku realizohet projekti, apo në një zyrë të posaçme;
2. Realizimit të anketave direkte me qytetarë të zonës ku mund të ketë ndikim projekti i mjedisit;
3. Sqarimeve nga ana e zhvilluesit për qëllimin e projektit, dhe dhënia e kontakteve ku qytetarët mund të dërgojnë mendimet e tyre. Kontaktet përfshijnë adresën postare, numrin e telefonit dhe postën elektronike.

Në përfundim të kësaj faze, zhvilluesi mbledh të gjitha materialet që ka përdorur për njoftimin, si dhe statistikën që ka nxjerrë, duke ia bashkalidhur dokumentacionit të aplikimit për Deklaratën Mjedisore.

Faza e katërt – Pasi janë kryer procedurat e njoftimit dhe të marrjes së mendimeve nga publiku apo palët e interesuara, zhvillohen dhe takimet publike. Për të realizuar dëgjuesat publike VKM-ja ka parashikuar bashkëpunimin midis zhvilluesit, AKM-së, Agjencisë Rajonale Mjedisore (ARM), njësive të qeverisjes vendore (NJQV).

Në VKM janë parashikuar detyrat dhe përgjegjësitë që do të ketë secili nga këto institucione në zhvillimin e procedurave të konsultimit publik.

A. Detyrat e zhvilluesit

Për zhvillimin e dëgjuesave publike, zhvilluesi duhet të kryejë detyrat e mëposhtme, konkretisht:

a) Të njoftojë AKM-në për dëgjuesin publik

Në njoftimin që zhvilluesi duhet ti dërgojë AKM-së, duhet t'i

bashkangjisë programin për organizimin e dëgjësës, raportin e thelluar të VNM-së, si dhe përmbledhjen joteknike të raportit.

b) Të njoftojë publikun për organizimin e dëgjësës publike

Zhvilluesi ka detyrimin për të marrë të gjitha masat për të njoftuar publikun. Njoftimin mund ta bëjë nëpërmjet vendosjes së tabelave informuese në vendin ku do të zhvillohet projekti apo përmes ekspozimit të materialeve të dëgjësës në zyrat e njësive të qeverisjes vendore, publikimit në median audiovizive, median e shkruar lokale etj. Njoftimi qëndron për 20 ditë rresht. Në dispozicion të publikut duhet të vihen edhe kopje të raportit të VNM-së dhe të përmbledhjes joteknike të tij, të cilat zhvilluesi ia dërgon NJQV dhe publiku mund të ketë akses në to. Kopje të printuara të raportit duhet t'i dërgohen dhe ARM-së, rreth 100 kopje.

c) Të sigurojë ambientin ku do të zhvillohet takimi

Zhvilluesi ka detyrimin të gjejë ambientin ku do të mbahet dëgjesa me publikun. Gjithashtu ka detyrimin që ditën që do të zhvillohet takimi, të sigurojë praninë e ekspertit/ekspertëve, që kanë hartuar raportin e thelluar të VNM-së.

d) Të marrë mendime nga publiku

Mendimet e dhëna nga publiku ditën e zhvillimit të takimit, duhet të merren në konsideratë dhe të paqyrohen në raportin e thelluar të VNM-së. Në rastet kur mendimet nuk janë marrë në konsideratë zhvilluesi i projektit duhet të arsyetojë shkaqet pse këto mendime nuk janë reflektuar.

Zhvilluesi ka të drejtë dhe të heqë dorë nga zhvillimi i seancës dëgjimore, duke njoftuar AKM-në. Njoftimi për heqjen dorë nuk

mund të bëhet më vonë se 20 ditë nga data kur është njoftuar AKM-ja për zhvillimin e seancës. Në këtë rast, AKM-ja informon ARM-në për ndërprerjen e procesit të organizimit të dëgjësës publike.

B. Detyrat e AKM-së

Pas marrjes së njoftimit nga zhvilluesi, AKM duhet të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:

1. Brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga zhvilluesi, AKM-ja duhet të nxjerrë udhëzime për ARM-në përkatëse, për rolin që ajo do të ketë në realizimin e dëgjësës publike.
2. Të publikojë në faqen e saj të internetit njoftimin për organizimin e dëgjësës publike brenda 5 ditëve nga njoftimi i zhvilluesit;
3. Ti dërgojë zyrtarisht një kopje të njoftimit strukturës përkatëse për komunikimin me publikun në ministri (nënkuptohet Ministria e Mjedisit), brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit;
4. Të bashkëpunojë me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën publike;
5. Të marrë mendimin e publikut në fazën e shqyrtimit të projektit për Deklaratën Mjedisore;
6. Të marrë në konsideratë rezultatet dhe kërkesat e publikut gjatë shqyrtimit për Deklaratën Mjedisore dhe procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
7. Të publikojë në faqen e saj të internetit informacionin që disponon për pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të projektit.

Sa më sipër, funksioni i AKM-së është menaxhimi dhe koordinimi i organeve të tjera publike në realizimin dhe zbatimin e detyrimeve për të njoftuar dhe përfshirë çdo person në procesin e konsultimit të një projekti.

C. Detyrat e Agjencisë Rajonale e Mjedisit

Pas marrjes së udhëzimeve të AKM-së, përveç detyrave të caktuara në udhëzim, ARM-ja ka përgjegjësinë të zbatojë dhe detyrimet e mëposhtme:

1. Bashkëpunon me zhvilluesin dhe NJQV-në për organizimin e dëgjësës publike;
2. Afishon në ambientet e saj të punës dhe publikon në faqen e saj të internetit njoftimin përkatës për dëgjësën publike, brenda 3 ditëve nga data e njoftimit të AKM-së;
3. Ekspozon në ambientet e saj të punës kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së;
4. Merr pjesë ditën e dëgjësës dhe mban shënim diskutimet e bëra nga të pranishmit;
5. I dërgon AKM-së raportin për diskutimet e bëra gjatë dëgjësës publike brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dëgjësja publike;
6. Bashkëpunon me zhvilluesin duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjësën.

D. Detyrat e Njesisë e Qeverisjes Vendore

Autoritet tjetër që përfshihet në proces është dhe njësia e qeverisjes vendore ku do të zhvillohet projekti. Duke qenë se është më pranë publikut, njësia mund të japë kontributin e saj në rritjen e ndërgjegjësimit dhe shkallën e përfshirjes së tij në veprimtari që ndikojnë në mjedis. Agjencia Rajonale e Mjedisit duhet të informojë njësinë e qeverisjes vendore brenda 3 ditëve nga marrja e njoftimit nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit për përgjegjësitë e mësipërme, si dhe i vendos në dispozicion kopjen e plotë të informacionit që ka marrë nga AKM.

Konkretisht NJQV duhet të zbatojë detyrimet e mëposhtme:

1. Publikon në ambientet dhe faqen e saj elektronike njoftimin përkatës për dëgjesën publike, brenda 3 ditëve nga data e njoftimit të ARM-së;
2. Ekspozon pranë zyrave të saj kopjet e përmbledhjes joteknike të raportit të VNM-së, brenda 3 ditëve nga data e njoftimit të ARM-së;
3. Bashkëpunon me zhvilluesin, duke i ofruar adresa e kontakte që disponon të OJF-ve dhe palëve që mund të kenë interes për dëgjesën publike;
4. Nxiti përfshirjen e komunitetit në pjesëmarrjen për dëgjesën publike;
5. Merr pjesë në ditën e zhvillimit të dëgjesës publike.

Sa më sipër, roli i njësisë së qeverisjes vendore është lehtësues në procesin e informimit dhe njoftimit të publikut për pjesëmarrjen në procesin e konsultimit.

E. Zhvillimi i seancës dëgjimore

Seanca dëgjimore duhet të zhvillohet pas kalimit të një afati 30 ditor nga dita kur zhvilluesi ka njoftuar AKM për zhvillimin e seancës. Seanca duhet të zhvillohet në një vend sa më afër vendodhjes së projektit.

Në takim marrin pjesë:

- a. zhvilluesi i projektit bashkë me ekspertët që kanë hartuar raportin e thelluar;
- b. përfaqësuesi i AKM-së dhe ARM-së;
- c. përfaqësuesi i NJQV në zonën ku zhvillohet projekti;
- d. palët e interesuara.

Në fillim prezantohen rezultatet e raportit të thelluar të VNM-së, më pas palët e interesuara shprehin mendimin e tyre mbi raportin.

Përfaqësuesit e ARM-së mbajnë shënim diskutimet e bëra gjatë seancës dhe i pasqyrojnë në një raport të veçantë, i cili i dërgohet AKM-së. AKM-ja e publikon raportin në faqen zyrtare.

Faza e pestë - Në këtë fazë zhvillohet procesi i informimi dhe konsultimit publik mbi Deklaratën Mjedisore.

Pas zhvillimit të procedurave të mësipërme, zhvilluesi bën aplikim për marrjen e Deklaratës Mjedisore. Brenda 5 ditëve nga marrja e aplikimit për Deklaratën Mjedisore, AKM publikon një njoftim me anë të të cilit informon publikun dhe palët e interesuara se projekti ka hyrë në fazën e shqyrtimit përfundimtar për lëshimin e Deklaratës Mjedisore.

Përveç sa më sipër, njoftimi përmban dhe informacionin në lidhje me mënyrën dhe afatin për dërgimin e mendimeve për ndikimin në mjedis të projektit. Mendimet mund të dërgohen nëpërmjet postës apo adresës elektronike që vendoset në dispozicion. Afati për dhënien e mendimeve është 20 ditë nga momenti i publikimit të njoftimit. Pas shqyrtimit të mendimeve, komenteve të palëve të interesuara, AKM-ja arsyeton mendimet/komentet që janë marrë parasysh dhe arsyet pse nuk janë marrë në konsideratë komentet e tjera.

Pas dhënie së Deklaratës Mjedisore, ajo bëhet publike në faqen e internetit të AKM-së dhe çdo palë ka të drejtë ta aksesojë atë.

1.3 Informimi dhe pjesëmarrja e publikut gjatë monitorimit

Përveç detyrimit të organeve për të përfshirë publikun në procesin e hartimit dhe dhënies së Deklaratës Mjedisore, VKM-ja ka parashikuar të drejtën e publikut për të marrë pjesë dhe në fazën e procesit të *monitorimit* të ndikimit në mjedis të projektit.

Monitorimi i ndikimit të projektit në mjedis është detyrë e zhvilluesit, i cili rezultatet e monitorimit me të dhënat përkatëse duhet t'ia dërgojë

Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Agjencisë Rajonale të Mjedisit dhe Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Për të pasur një proces sa më transparent, këto organe duhet t'i publikojnë menjëherë në faqen e tyre të internetit të dhënat e monitorimit. Më pas çdo palë e interesuar ka të drejtë që të marrë një kopje të të dhënave të monitorimit të paraqitura nga zhvilluesi pas paraqitjes së kërkesës pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit apo Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

Përfshirja e publikut në këtë fazë realizohet duke i dhënë atij të drejtën të japë komente dhe të dërgojë mendime për *të dhënat e monitorimit* pranë këtyre institucioneve.

1.4 Procedurat e ankimit administrativ

VKM-ja parashikon të drejtën e çdo subjekti për të paraqitur ankim ndaj veprimeve apo mosveprimeve të organit publik në lidhje me zhvillimin e procedurës së njoftimit dhe konsultimit publik. Organi kompetent ku paraqitet ankimi është Ministri. Pavarësisht se VKM-ja nuk e ka parashikuar ministrin kompetent referuar dhe organeve publike mbi të cilat bien detyrimet e parashikuara në VKM, ministri kompetent është Ministri i Mjedisit.

Në VKM nuk janë parashikuar procedurat për shqyrtimin e ankesave dhe për këtë arsye do t'i referohemi rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, për shqyrtimin e ankimeve.

2. Konsultimi i drafteve që ndodhen për shqyrtim në Kuvend

Siç e shpjeguam edhe më lart, ligji për konsultimin publik parashikon detyrimin e autoriteteve publike që të zhvillojnë konsultime publike

për draftet që hartojnë, për sa kohë draftet nuk janë dërguar ende për miratim të mëtejshëm, deri në Kuvend. Mirëpo, diskutimet në Kuvend janë të një rëndësie të veçantë sepse:

- a. Draftet e propozuar nga deputetët nuk kalojnë në asnjë fazë konsultimi publik;
- b. Draftet e propozuar nga Këshilli i Ministrave mund të ndodhë që të kenë pësuar ndryshime nga drafti fillestar i konsultuar me publikun nga autoriteti publik hartues;
- c. Draftet mund të pësojnë ndryshime thelbësore në diskutimet nëpër komisionet e përhershëm parlamentarë;
- d. Ligjet e kthyer nga Presidenti i Republikës, në rastet kur dekreti i Presidentit nuk është rrëzuar nga Kuvendi, mund të pësojnë ndryshime;
- e. Draftet mund të pësojnë ndryshime edhe në seancë plenare.

Për këto arsye, meqënëse ligji nuk parashikon një mjet efektiv për këtë instancë, Kuvendi ka zhvilluar një procedurë të veçantë të konsultimit publik për shqyrtimin e projektligjeve që ndodhen në shqyrtim pranë tij. Kuvendi ka miratuar një *manual* për pjesëmarrjen e publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit të Shqipërisë.

Manuali i pjesëmarrjes së publikut në procesin vendimmarrës të Kuvendit është një burim për të nxitur dhe siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në funksionin legjislativ dhe atë mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë. Pjesëmarrja, sidomos e shoqërisë civile në procesin ligjvënës të Kuvendit, i shërben përmirësimit të cilësisë së legjislacionit të shqyrtuar dhe miratuar. Ajo merr rëndësi të veçantë kur diskutohen çështje që kanë të bëjnë me grupe në nevojë, si personat me aftësi të kufizuara, gratë, fëmijët, minoritetet, etj.

Qëllimi i këtij manuali është t'i krijojë mundësinë publikut, që nga qytetari i thjeshtë e deri tek organizatat jofitimprurëse, të shndërrohen në pjesëmarrës aktivë të zhvillimit të komunitetit ku

bëjnë pjesë dhe në ofrues të përmirësimit të politikave ligjore prej të cilave preken.

2.1. Parimet

Në këtë manual, pjesëmarrja e publikut është trajtuar mbi bazën e informimit, konsultimit, dialogut dhe partneritetit. Disa nga parimet mbi të cilat zhvillohet konsultimi publik janë disa parime, të cilat janë analizuar në kapitullin e parë të këtij komentari, si transparenca, nxitja e pjesëmarrjes së publikut, mosdiskriminimi, informimi, konsultimi, dialogu, partneriteti.

2.2. Transparenca e Kuvendit

Kuvendi ka një faqe zyrtare internet www.parlament.al, e cila është një faqe funksionale ku publikohen të gjithë projektligjet dhe informacioni mbi miratimin e tyre, si dhe çdo informacion i nevojshëm mbi veprimtarinë e Kuvendit.

Konkretisht faqja e internetit e Kuvendit përmban:

- Tekstin e projektligjeve të depozituara, së bashku me relacionin shoqërues të tyre;
- Kalendarin e punës së komisioneve të përhershme dhe ecurinë e shqyrtimit të projektligjeve;
- Tekstin e amendamenteve të depozituara në komisione dhe të amendamenteve të miratuara prej tyre;
- Raportet e komisioneve parlamentare, të cilat shqyrtojnë projektligjin;
- Procesverbalet e mbledhjeve të Konferencës së Kryetarëve, të komisioneve dhe të këshillave;
- Ligjet e miratuara, pas shpalljes nga Presidenti i Republikës;

- Rendin e ditës së punës në komisione;
- Rendin e ditës së punës në seancë plenare;
- Si dhe çdo material tjetër që konsiderohet i nevojshëm për transparencën parlamentare.

Veprimtaria e hapur dhe transparente e Kuvendit realizohet nëpërmjet:

- a. pjesëmarrjes së publikut në procesin ligjvënës;
- b. pasqyrimin të veprimtarisë së Kuvendit dhe organeve të tij në median e shkruar dhe vizive;
- c. botimeve të dokumentacionit parlamentar;
- ç. faqes së internetit të Kuvendit;
- d. rrjetit të brendshëm audiovizual.

Përveç faqes së internetit, të interesuarit mbi punimet e Kuvendit të Shqipërisë, kanë mundësinë të marrin një informacion elektronik të shpejtë e mjaft të dobishëm, orientues, të përditësuar e transparent përmes dy pikave të informimit *Info Point* të vendosura respektivisht në ambientet e Kuvendit. Ky sistem informativ përmban, ndër të tjera, informacionet kryesore mbi vendin, orën, rendin e ditës së punimeve në seancë plenare, komisione parlamentare, por edhe sa i përket veprimtarive të tjera parlamentare.

Gjithashtu veprimtaria e Kuvendit mund të transmetohet nga mediat audiovizive. Televizioni Publik Shqiptar (tashmë në platformën digjitale) ka detyrimin të transmetojë seancën plenare, në të cilën diskutohen:

- miratimi i programit politik dhe i përbërjes së Këshillit të Ministrave;
- seancat e pyetjeve;
- seancë e përjavshme e pyetje-përgjigjeve;
- interpelancat;

- interpelancat urgjente;
- mocionet;
- mocionet e besimit dhe të mosbesimit;
- raportet e komisioneve hetimore;
- nismat për rishikim të Kushtetutës.

2.3. Konsultimi publik që zhvillohet nga Kuvendi

a. Çështjet që i nënshtrohen konsultimit publik

Sipas manualit, Kuvendi realizon konsultim publik për çështjet e mëposhtme:

- çështje që kanë të bëjnë me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi;
- shqyrtimit të projektligjeve;
- çështje që lidhen me veprimtarinë e Kuvendit me karakter edukues, promovues, shkencor, etj.

Ashtu siç është parashikuar dhe në ligjin për konsultimin publik, janë të përjashtuar nga konsultimi publik:

- çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë kombëtare;
- çështjet që lidhen me sekretin shtetëror sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- vendimet e Kuvendit.

Krahas rasteve të mësipërme, Kuvendi mund të vendosë që një çështje të mos i nënshtrohet konsultimit publik në rastet e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.

b. Subjektet që marrin pjesë në konsultimin publik

Sipas manualit, palët që kanë të drejtë të marrin pjesë gjatë konsultimeve publike në veprimtarinë e Kuvendit janë:

Palët e interesuara nga autoritete publike

Në këtë kategori përfshihen anëtarë apo përfaqësues të Këshillit të Ministrave, si dhe përfaqësues të lartë të autoriteteve publike.

Palët e interesuara nga publiku

Në këtë kategori përfshihen individët, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Këto mund të jenë përfaqësuesit e qytetarëve (përfshirë edhe fëmijët e shoqëruar nga të rriturit), të cilët janë të prekur nga një ligj apo politikë e caktuar; organizata të shoqërisë civile; ekspertë të pavarur; ekspertë të organizatave të shoqërisë civile; organizata të punëmarrësve; shoqata të bizneseve apo shoqata të ndryshme profesionale; etj.

Organizatat e shoqërisë civile kanë një rëndësi dhe përparësi për zhvillimin e konsultimeve publike. Për këtë arsye Kuvendi ka krijuar Regjistrin Elektronik të Shoqërisë Civile (informacioni i këtij regjistri është depozituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, sipas Sistemit të Integruar Tatimor, ku të gjitha organizatat e shoqërisë civile janë aktive). Ky regjistër, është një element kyç për identifikimin e këtyre organizatave, si dhe shërben si mjet lidhës e komunikues me Kuvendin e Shqipërisë.

Koordinatori për grupet e interesit

Për të lehtësuar dhe bashkërenduar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis Kuvendit dhe palëve të ineteresuara, është caktuar një person përgjegjës që është Koordinatori për grupet e interesit.

Në manual janë përcaktuar dhe detyrat kryesore që ka Koordinatorin për grupet e interesit, konkretisht:

- Të informojë grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë për projektligjet që do të shqyrtohen dhe diskutohen në Komisionet e Përhershme Parlamentare;
- Të kontaktojë me grupet e interesit për tërheqjen e mendimit me shkrim për projektligjet që shqyrtohen dhe diskutohen në Komisionet Parlamentare;
- T’i përcjellë në kohë stafit të Komisioneve të Përhershme Parlamentare, mendimet dhe sugjerimet e grupeve të interesit, shoqërisë civile dhe partnerëve socialë;
- Të njoftojë në kohë grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë, për pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e komisioneve parlamentare, kur kjo të çmohet e arsyeshme nga drejtuesit e komisioneve parlamentare;
- Të informojë grupet e interesit, shoqërinë civile dhe partnerët socialë për ligjet e miratuara dhe marrjen në konsideratë ose jo të sugjerimeve të tyre dhe arsyetimin në rastin e fundit.

c. Seancat dëgjimore publike

Për të realizuar konsultimin publik me palët e interesuara, Kuvendi realizon seance dëgjimore, sipas parashikimeve në Rregulloren e Brendshme të Kuvendit. Rastet kur Kuvendi realizon këto seanca dëgjimore i grupojmë si më poshtë:

- a) për të marrë informacion për çështje që lidhen me kontrollin e zbatimit të legjislacionit në një fushë të caktuar;
- b) gjatë procesit të shqyrtimit të një projektligji (gjatë procesit legjislativ).

Zhvillimi i seancave dëgjimore është kusht për kalimin e projektligjit

për shqyrtim në seancë plenare. Komisioni nuk mund të përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore.

Në manual janë përcaktuar edhe disa nga arsyet pse ka rëndësi zhvillimi i seancave dëgjimore. Më poshtë po listojmë disa nga këto arsye:

Shkëmbimi i informacionit

Deputetët dhe publiku përfitojnë nga procesi i shkëmbimit të informacionit. Seanca dëgjimore publike i lejon deputetëve t'i paraqesin publikut nismat ligjore në mënyrë formale dhe të organizuar. Ata kanë mundësi gjithashtu të marrin informacion të vlefshëm nga të gjitha palët e interesuara për formulimin e politikave alternative, gjatë diskutimit për efektivitetin e një ligji në fuqi apo shqyrtimit të një projektligji. Informacioni që kanë palët e interesuara vjen në formën e eksperiencave të personave që janë prekur nga zbatimi në praktikë i një ligji të miratuar apo që preken nga përcaktimet e një projektligji. Informacioni i paraqitur para deputetëve i krijon mundësinë palëve të interesuara të marrin pjesë në shqyrtimin e legjislacionit në mënyrë aktive dhe njëkohësisht i bën ato më të përgjegjshme për të vëzhguar politikatat legjislative që i prekin.

Të dhënat apo njohuritë alternative dhe ofrimi i zgjidhjeve

Gjatë zhvillimit të një seance dëgjimore, politika e zbatuar nga një ligj i miratuar, apo e propozuar nëpërmjet një projektligji, shihet nga këndvështrime të ndryshme: nga njëra anë është informacioni i atyre që e kanë hartuar atë, ndërsa nga ana tjetër është informacioni i atyre që do të preken prej saj. Informacioni i sjellë nga palët e interesuara përbëhet nga vlera dhe njohuri lokale që shpesh ekspertët i “injorojnë” gjatë procesit të hartimit të një projektligji, me synimin për të qenë sa më përfshirës dhe përgjithësues në

normat e hartuara. Organizatat e shoqërisë civile kanë si objekt të punës së tyre krijimin dhe promovimin e një morie vlerash në dobi të shoqërisë dhe ato, në më të shumtën e rasteve kanë zhvilluar dhe përparuar profilizimin e tyre në një fushë të caktuar, aq sa, përmes ekspertizës së tyre mund të japin alternativa të vlefshme për t'u shqyrtuar nga komisionet parlamentare.

Mund të jetë edhe rasti kur, opinionet e palëve të interesuara, megjithëse janë dhënë, nuk janë marrë parasysh prej grupit hartues të projektligjit në fazën e konsultimit dhe dëgjimi në komisionet parlamentare është një shans i dytë për propozimet alternative. Dëgjimi i dy perceptimeve dhe interpretimeve të ndryshme i jep mundësinë deputetëve të vlerësojnë impaktin e legjislacionit të zbatuar ose të propozuar dhe për rrjedhojë ata marrin vendime më të mira.

Gjithashtu seancat dëgjimore publike, shpesh janë tryezat ku zhvillohen debatet mes përfaqësuesve të qeverisë dhe palëve të interesuara, për çështje të përmbajtjes së një projektligji, apo edhe për çështje të zbatimit të një ligji. Ato shërbejnë për zgjidhjen e tensioneve të krijuara si dhe për dhënien e zgjidhjeve të pranueshme nga të gjitha palët.

Fuqizimi i përfshirjes së publikut

Fuqizimi i përfshirjes së publikut, në procesin kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe sidomos në procesin ligjvënës, është qëllimi qendror i këtij manuali. Seancat dëgjimore publike janë mekanizmi për të fuqizuar përfshirjen e publikut në kuptim të konsultimit dhe dialogut. Fuqizimi i pjesëmarrjes së publikut në veprimtarinë e Kuvendit rrit llogaridhënien dhe transparencën e aktivitetit të deputetëve në përfaqësimin e interesave të zgjedhësve të tyre.

Besimi

Zhvillimi i seancave dëgjimore krijon dhe rrit besimin e publikut tek institucioni i Kuvendit si institucion përfaqësues dhe te deputetët në veçanti. Zhvillimi i seancave dëgjimore i jep mundësi publikut të vlerësojë vullnetin dhe aftësinë e deputetëve për të dëgjuar zërin e atyre që përfaqësojnë.

Kultura e pjesëmarrjes

Seancat dëgjimore publike ndihmojnë në transformimin nga kulturë teknokratike dhe politike të shqyrtimit të një çështjeje, në një kulturë dialogu të hapur dhe bashkëpunimi mes palëve të interesuara dhe Kuvendit. Zhvillimi i kësaj kulture synon të sigurojë shërbime dhe ekspertiza profesionale të dhëna nga organizatat e shoqërisë civile, përmes partneritetit dhe ndërtimit të besimit të ndërsjellë, dhe më e rëndësishmja, pa kosto buxhetore.

d. Koha kur zhvillohet seanca dëgjimore publike

Koha e zhvillimit të seancave dëgjimore është përcaktuar në Rregulloren e Brendshme, megjithëse duhet të theksojmë që nuk kemi një rregullim konkret për caktimin e zhvillimit të seancave dëgjimore, por nga një interpretim i rregullores rezulton që seanca dëgjimore zhvillohet pas momentit të shqyrtimit në parim të projektligjit dhe para shqyrtimit të tij nën nën në Komision.

e. Njoftimet e palëve për seancat dëgjimore

Përpara se Kuvendi të bëjë njoftimet për organizimin e seancave dëgjimore, duhet të identifikojë grupet e interesit. Procesi identifikimit është thelbësor, pasi kohëzgjatja e një seance dëgjimore është 2-3 orë dhe Komisioni mund të dëgjojë një numër të kufizuar personash,

prandaj është e rëndësishme të përzgjidhen ato palë të interesuara nga publiku, që preken drejtpërdrejt nga një ligj ose projektligj, apo ato që kanë ekspertizë sektoriale për të vlerësuar cilësinë e tij.

Pas identifikimit të palëve të interesuara dhe caktimit të çështjeve që do të shqyrtohen, caktimit të datës dhe orës së zhvillimit të seancës dëgjimore, Kuvendi bën njoftimet. Njoftimi duhet të përmbajë:

1. Arsytet përse është konsideruar e nevojshme pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin e diskutimit të projektaktit;
2. Afatin dhe mënyrën me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
3. Adresën e personit të kontaktit për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
4. Vendin, datën dhe orën e organizimit të seancës dëgjimore;
5. Një kopje të projektaktit që do të shqyrtohet;
6. Minutazhin që kanë palët për t'u shprehur.

Njoftimi mund të kryhet në një apo disa nga format e mëposhtme:

- Me postë elektronike;
- Me telefon, faks
- Nëpërmjet shërbimit postar kur njoftimi nuk mund të bëhet me mënyrë tjetër.

Gjithashtu njoftimi për organizimin e seancës dëgjimore publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

f. Shprehja e interesit nga palët e interesuara për të marë pjesë në seancat dëgjimore

Komisionet parlamentare konsiderohen si ura lidhëse mes publikut dhe Kuvendit, duke qenë se ato përbëhen nga një grup i vogël

deputetesh dhe kjo lehtëson zhvillimin e dialogut mes palëve të interesuara nga publiku dhe Kuvendit.

Të drejtën për të marrë pjesë në seancat dëgjimore që zhvillohen nga Kuvendi, përveç grupeve të interesit të identifikuar nga vetë Kuvendi, e ka dhe çdo person apo grup i interesuar. I vetmi kusht që duhet të plotësojë personi/grupi i interesuar është paraqitja e një kërkesë, me anë të së cilës të shprehë interesin për pjesëmarrje. Kërkesa duhet të përmbajë elementet e mëposhtëm:

- Një prezantim të organizatës së shoqërisë civile, grupit të interesit apo grupimit të interesuar. Në rastin e OJF-ve duhet të përmenden edhe të dhëna të aktit të regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi për OJF-të;
- Çështjen për të cilën kërkohet pjesëmarrja sipas kalendarit të punimeve të Komisionit të përhershëm;
- Arsyet pse kërkohet pjesëmarrja;
- Emrat e personave që do të përfaqësojnë palën e interesuar, adresën e saktë dhe kontaktet e tyre;
- Materiale të tjera shtesë në funksion të paraqitjes së arsyeve për pjesëmarrje, nëse palët e interesuara e shohin të nevojshme.

Kërkesa duhet të jetë e argumentuar mirë, me qëllim që të merret parasysh nga Kuvendi, pasi seancat dëgjimore publike kanë një kohëzgjatje të kufizuar dhe komisionet përpiqen të përzgjedhin ato palë të interesuara që arrijnë të shprehin më qartë problematikat e çështjeve të caktuara, ose që janë të mirënjohura në aktivitetin që zhvillojnë.

Pas marrjes së kërkesës për pjesëmarrje, Kryesia e Komisionit vendos nëse do të zgjerojë listën e të ftuarve të palëve të interesuara nga publiku, apo jo. Për seancat dëgjimore gjatë shqyrtimit të një projektligji, Kryesia e Komisionit mund të vendosë që të mos e

ftojë palën e interesuar të marrë pjesë në seancën dëgjimore, por që rekomandimet e paraqitura prej saj t’i paraqiten Komisionit, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit.

g. Zhvillimi seancës dëgjimore publike

Seancat dëgjimore publike zhvillohen kryesisht në hapësirat e Kuvendit, ku ekziston mundësia më e mirë teknike dhe logjistike për t’i realizuar ato. Por, ato mund të mbahen edhe në hapësira jashtë ndërtesës së Kuvendit, me qëllim që qytetarët të kenë më të lehtë pjesëmarrjen, në rastet kur është e nevojshme prezenca e një grupi të caktuar prej tyre. Shembull për këtë është zhvillimi i konsultimeve publike për reformën në drejtësi, ku takimet me publikun janë zhvilluar edhe në ambientet universitare të qyteteve të ndryshme.

Zhvillimi i seancës dëgjimore i nënshtrohet rregullave të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit, për shqyrtimin e çështjeve në komisione. Kryetari i Komisionit u jep fjalën të gjithë të ftuarve brenda kohës së caktuar për diskutim (zakonisht deri në 10 minuta), sipas radhës së vendosur prej tij për diskutimet. Në rastet kur të ftuarit i kanë përgatitur diskutimet me shkrim, një kopje e tyre i vihet në dispozicion sekretarisë së Komisionit, e cila më pas ia shpërndan deputetëve në komision.

Gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore mbahet proceverbali, ku janë të pasqyruara diskutimet e zhvilluara. Procesverbali i seancës dëgjimore publikohet në faqen zyrtare të internetit të Kuvendit dhe sekretaria e Komisionit ia dërgon atë të ftuarve pjesëmarrës në seancën dëgjimore, brenda 2 ditëve nga zbardhja e tij.

g. Paraqitja e rekomandimeve nga shoqëria civile

Në manual janë parashikuar rregulla për mënyrën e paraqitjes së rekomandimeve dhe shqyrtimit të tyre nga Kuvendi.

Shoqëria civile me anë të rekomandimeve të saj, mund të marrë pjesë në procesin legjislativ në këto faza:

- Gjatë fazës së draftimit/hartimit të një projektligji
- Gjatë seancave dëgjimore

Rekomandimet për ndryshime në një projektligj duhet të jenë të referuara saktë në nenin që propozohet të ndryshohet dhe të jenë të shkruara sipas rregullave të teknikës legislative. Për këtë arsye, nevojitet që organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit të kenë në dispozicion ndihmën e një ose disa juristëve me përvojë, të cilët do të duhet të përgatisin materialin përkatës, pasi teknika legislative kërkon njohuri dhe eksperiencë të posaçme.

i. Afati për dërgimin e rekomandimeve

Rekomandimet duhet të dërgohen brenda 10 ditësh nga data kur drafti i projektligjit është publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit, ose pas kërkesës së shprehur të Kuvendit.

Ky afat mund të reduktohet në raste urgjence, ose kur palët e interesuara shprehen të gatshme të paraqesin rekomandimet e tyre më shpejt. Gjithsesi, dorëzimi i rekomandimeve me shkrim, nëse ka të tilla, nga palët e interesuara, do të bëhet jo më vonë se 3 ditë para zhvillimit të seancës dëgjimore.

Afat 10 ditor, mund të zgjatet në këto raste:

- Për shkak të natyrës së veçantë të projektligjit që diskutohet (kompleksiteti i temës që është hedhur për diskutim publik, diversiteti i grupeve të shoqërisë civile që kanë shprehur interes etj.);
- Në rastet kur përkon me periudhën e pushimeve të deputetëve.

Pas marrjes së rekomandimeve, stafi i Komsioneve të Kuvendit, bën konfirmimin e marrjes së tyre, duke kthyer përgjigje me email ose me mjete të tjera. Me përfundimin e afatit për paraqitjen e rekomandimeve, komisioni mbyll procesin e konsultimit për projektligjin në fjalë dhe vazhdon shqyrtimin e tij në fazat e tjera të procesit legjislativ.

j. Shqyrtimi i rekomandimeve

Rekomandimet e dorëzuara nga palët e interesuara, duhet t'i dërgohen deputetëve të paktën një ditë përpara zhvillimit të seancës dëgjimore.

Pas zhvillimit të seancës dëgjimore gjatë procesit legjislativ, stafi i Komisionit përgatit një material përmbledhës me të gjitha rekomandimet e sjella nga palët e interesuara nga publiku, duke i kategorizuar propozimet në ato që kanë të bëjnë me thelbin e çështjeve që trajtohen (substantive), dhe në propozime teknike që kanë të bëjnë më shumë me aspekte të gjuhës, apo me rregullime të tekstit.

Në përfundim përgatitet një material pune ku përfshihen të gjitha rekomandimet, i cili iu dërgohet anëtarëve të komisionit përgjegjës, dhe për dijeni dhe Kryetarit të Komisionit për dhënie mendimi, si dhe relatorit/relatorëve të këtij Komisioni për çështjen në fjalë.

Gjatë shqyrtimit nën për nën të projektligjit, Komisioni mban parasysh edhe materialin me rekomandimet e shoqërisë civile dhe me shumicë votash vendos për qendrimin që do të mbajë në lidhje me rekomandimet në fjalë.

Në rastet kur vendoset që rekomandimet e paraqitura të mos merren parasysh (plotësisht apo pjesërisht), vlen i njëjti rregull si në rastin e ligjit për konsultimin publik, që duhet të argumentohen arsyet përse është mbajtur një qendrim i tillë.

Vendimi i Komisionit u bëhet i ditur përfaqësuesve të palëve të interesuara që kanë paraqitur rekomandimet. Në raportin përfundimtar të Komisionit mbi projektligjin duhet të përshihet dhe një përmbledhje e rekomandimeve të shoqërisë civile që janë marrë në konsideratë.

k. Shprehja e interesit nga palët e interesuara për zhvillimin e seancave dëgjimore

Krahas zhvillimit të seancave dëgjimore me nismën e Kuvendit, palët e interesuara mund të kërkojnë nga Kuvendi që të zhvillojë një seancë dëgjimore me kërkesë të tyre. Palët e interesuara duhet të paraqesin një kërkesë për shprehje interesi, në të cilën duhet të përcaktojnë temën/problematikën për të cilën kërkojnë zhvillimin e seancës.

Në manual është përcaktuar që palët duhet të tregojnë kujdes në për zgjedhjen e temës, e cila duhet të jetë brenda fushës së përgjegjësisë së Komisionit dhe të mos jetë trajtuar në një kohë të afërt nga po ai Komision. Në praktikë ndodh që për të njëjtin draft të shprehen shumë komisione dhe tema e diskutimit në secilin prej tyre është e ndryshme, pavarësisht draftit që është i njëjtë. Për shembull, amendamenti që rregullon importin e mbetjeve duhej të kalojë në *Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin* për të trajtuar aspektin industrial dhe impaktin në mjedis, *Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut* për të trajtuar aspekte tekniko-legjislative, përputhjen e tij me ligje të tjerë dhe impaktin në të drejtat e njeriut, *Komisionin për Integrimin Evropian* për të trajtuar aspektin e përputhjes me legjislacionin e Bashkimit Evropian, etj. Diskutimi në secilin komision është i ndryshëm dhe përfaqësuesit e publikut duhet të trajtojnë temën sipas fushës së secilit komision dhe jo të zhvillojnë të njëjtin diskutim në secilin prej tyre.

Gjithashtu palët duhet të kenë parasysh edhe kohën për zhvillimin e

seancës. Pas miratimit të kërkesës për zhvillimin e seancës, ajo do të zhvillohet sipas rregullave që rregullojnë seancat dëgjimore që nisen nga Komisioni.

l. Pjesmarrja e publikut në seancat e komisioneve të përhershme dhe seancën plenare

Seancat e komisioneve të përhershme dhe seanca plenare janë të hapura për publikun, përveç rasteve kur për shkak të natyrës së projektaktit vendoset që ato të zhvillohen të mbyllura. Vendimi për të zhvilluar seancën e mbyllur merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

Çdo person i interesuar duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim, të paktën 5 ditë përpara zhvillimit të seancës në rastin e komisioneve të përhershme dhe 7 ditë përpara në rastin e seancave plenare, e cila duhet të përmbajë të dhënat e personit, datën dhe mbledhjen në të cilën kërkon të marrë pjesë, si dhe një adresë ose numër kontakti të tij.

Kërkesa shqyrtohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, në bashkëpunim me shërbimet e Kuvendit, duke mbajtur parasysh kapacitetin e sallës së komisionit në mbledhjen e tij ose seancës plenare, ku kërkohet pjesëmarrja. Në rast se për atë mbledhje janë paraqitur shumë kërkesa për pjesëmarrje, Sekretari i Përgjithshëm vlerëson sipas radhës së paraqitjes kërkesat që janë paraqitur më të parat. Pas këtij vlerësimi njoftohen personat kërkuar.

m. Paraqitja e peticioneve

Me peticione do të kuptojmë ato dokumente të nënshkruara nga një grup individësh të cilët i kërkojnë Kuvendit të kryejë ose të mos kryejë një veprim të caktuar.

Në nenin 104 të Rregullores së Brendshme të Kuvendit përcaktohen procedurat në lidhje me dërgimin e peticioneve dhe shqyrtimin e tyre nga Kuvendi.

Peticioni që i dërgohet Kuvendit duhet të dërgohet në formë të shkruar dhe të përmbajë elementet e mëposhtme:

- Emrin e dërguesit;
- Nënshkrimet përkatëse;
- Të jetë i kuptueshëm;
- Të tregojë qartë objektin e tij.

Peticionet shqyrtohen nga komisionet e përhershme përkatës që kanë lidhje me objektin e paraqitur në peticion. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së peticionit, kryetari i komisionit përkatës e paraqet peticionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën e zgjidhjes ligjore ose mospranimin e peticionit. Kryetari i komisionit mund t'ia kthejë peticionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë. Siç vihet re, afati 45 ditor është i gjatë dhe imponon durim nga nënshkruesit, të cilët duhet të presin për të gjetur bashkëpunimin me qëllim realizimin e objektit të peticionit. Për këtë arsye është e rekomandueshme që peticionet të dërgohen sa më shpejt, në mënyrë që të fitohet kohë për çështjen që trajtohet.

Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme për zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarra dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në peticion i njoftohen dërguesve të peticionit

ANALIZË KRAHASIMORE E DY VITEVE TË PARA TË ZBATIMIT TË LIGJIT PËR KONSULTIMIN PUBLIK

1. Metodologjia


Res Publica ka testuar ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” duke mbledhur të dhëna në dy periudha të ndryshme 7 mujore, për periudhën Nëntor 2015 - Maj 2016 dhe periudhën Shtator 2016 - Mars 2017.

Për periudhën e dytë, Shtator 2016 - Mars 2017, Res Publica ka monitoruar 61 autoritete publike, duke mbajtur të njëjtin numër me numrin autoritetesh të monitoruara në periudhën e mëparshme, me qëllim për të pasur të dhëna sa më të sakta krahasimore. Përzgjedhja e autoriteteve publike është bërë në bazë të numrit dhe rëndësisë së projekteve që kanë trajtuar.

Gjithashtu është monitoruar faqja zyrtare e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale www.idp.al, dhe faqja e Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike www.konsultimipublik.gov.al, e cila është faqja e përbashkët e të gjithë autoriteteve publike, me qëllim për të krahasuar funksionalitetin e saj në dy periudhat kohore të përmendura më sipër.

2. Autoritetet publike të monitoruara

Fig.5 – Autoritetet publike të monitoruara




Duke qenë se organet publike që hartojnë dhe propozojnë më shumë projektakte janë organet e pushtetit qendror, kryesisht Ministrinë, numri i autoriteteve të monitoruara që i përkasin kësaj kategorie është më i lartë, konkretisht pothuasje gjysma e numrit të përgjithshëm të autoriteteve publike.

3. Përfshirja e rubrikës për konsultimet publike në faqet e internetit të institucioneve

Në ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet se të gjithë organet publike do të publikojnë projektaktet në një regjistr të vetëm që aktualisht është faqja zyrtare e Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Procedura e funksionimit të faqes është parashikuar në VKM nr. 828, datë 07.10.2015. Duke qenë se krijimi dhe aktivizimi i një faqeje të përbashkët kërkonte kohë, në VKM u la një mundësi që autoritet publike të vazhdonin të publikonin projektaktet në faqet e tyre zyrtare.


Megjithëse VKM ka më shumë se një vit që ka hyrë në fuqi, Regjistri Elektronik ende nuk është bërë aktiv dhe funksional. Për këtë arsye Res Publica, për të dytin vit rradhazi, ka monitoruar faqet zyrtare të organeve publike, me qëllim evidentimin e zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik, duke i krahasuar të dhënat me monitorimin e realizuar në periudhën e mëparshme.

Fig.6 - Rubrikat për konsultimin publik në faqet e internetit të autoriteteve



Siç rezulton dhe nga grafiku i mësipërm situata vazhdon të jetë e saktësisht e njëjtë. Më shumë se gjysma e autoriteteve publike vazhdojnë të mos e zbatojnë ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e qytetarëve për t'u njohur dhe për t'u përfshirë në proceset politikëbërëse. Nga 61 autoritetet publike të monitoruara rezulton që vetëm 28 autoritete publike kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare rubrika për njoftimin dhe konsultimin publik për projektaktet, ndërsa 33 autoritete vazhdojnë të mos publikojnë asnjë informacion në lidhje me projektaktet që hartojnë.

Fig.7 – Funksionaliteti i faqeve të internetit lidhur me konsultimin publik




Siç konstatohet dhe nga grafiku, numri i autoriteteve që e kanë faqen zyrtare funksionale përsa i përket rubrikave të njoftimit dhe konsultimit publik është 61 % në raport me 39% të atyre autoriteteve që kanë një rubrikë për njoftimet dhe konsultimet publike, por kjo rubrikë është jofunksionale. Duke i krahasuar këto rezultate me rezultatet e periudhës së mëparshme dalim në konkluzionin që është rritur me 11 % numri i institucioneve që kanë përmirësuar dhe e kanë bërë të efektshme rubrikën për konsultimin publik. Ky është tregues i një përmirësimi të lehtë, por i pamjaftueshëm për t’u konsideruar domethënës.

Ndërkohë, për t’u theksuar është edhe fakti që shpesh autoritetet publike nuk kujdesen për publikimin e drafteve në vendin e duhur, por i gjen draftet në kënde të ndryshme të faqes së internetit, pa ndjekur ndonjë rregull. Materialet e publikuara, shpesh janë të pjesshme dhe nuk ka të dhëna për kohën e konsultimit dhe detaje të tjerë për të mundësuar publikun të njihet plotësisht me nismën për draftin.

4. Koordinatorët për njoftimin dhe konsultimin publik

Fig. 8 – Caktimi i koordinatorëve për konsultimin publik




Nga grafiku i mësipërm konstatohet se vetëm 1/10 e autoritete të monitoruara kanë caktuar koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik. Duke i krahasuar këto të dhëna me rezultatet e mëparshme konkludojmë që vërtet është rritur dy herë numri i autoriteteve që kanë caktuar koordinatorë, por ky numër është ende tepër i ulët. Duhet të theksojmë që ligji për njoftimin dhe konsultimin publik ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2015, pra gati 2 vjet më parë dhe autoritetet publike vijojnë të mos zbatojnë detyrimet minimale që rrjedhin nga ky ligj.

5. Rregjistri për listën e projekteve për konsultimin publik

Më lart kemi analizuar detyrimin e çdo organi publik për të publikuar projektaktet që ka hartuar në Regjistër. Duke qenë se kjo faqe nuk është ende funksionale, janë monitoruar faqet zyrtare të autoriteteve, me qëllim konstatimin nëse në rubrikat e konsultimit publik gjenden të publikuara në mënyrë hierarkike aktet që janë në proces konsultimi ose që janë miratuar.

Fig.9 - Rregjistrat për listën e projekteve për konsultimin publik



Siç konstatohet nga grafiku i mësipërm kemi një përmirësim të situatës përsa i përket organizimit të projekteve të cilat i nënshtrohen konsultimit publik. Nga 28 institucionet që kanë rubrikat apo përmbajnë informacione për konsultimet publike, rezulton që 50% e tyre i kanë të renditura dhe të organizuara projektaktet që i nënshtrohen konsultimit publik. Duke i krahasuar me rezultatet e mëparshme, konkludojmë që kemi një përmirësim më të ndjeshëm të situatës. Gjithsesi, jemi ende larg përmbushjes në mënyrë të plotë të detyrimeve që rrjedhin nga ligji për njoftimin dhe konsultimin publik.

6. Raste studimore nga vendimet e Komisionerit

Në faqet 57-62 më lart është dhënë një pasqyrë e vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, i cili është organi që shqyrton ankesat dhe kërkon marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës.

Deri tani rezulton se ka një numër tepër të ulët të ankesave të paraqitura, ndërkohë që Komisioneri nuk ka marrë masa. Vetëm në një rast rezulton se Komisioneri ka vendosur të marrë masa ndaj personave përgjegjës dhe kjo ka ndodhur pas afro dy vitesh pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet se Komisioneri shpreh shqetësimin që nuk ka shumë hapësirë ligjore për ta bërë këtë ligj funksional. Mosaplikimi i sanksioneve e bën ligjin të mos ketë “dhëmbë” dhe të lehtësojë shpërfilljen e tij. Vendimet e vakëta të Komisionerit dekurajojnë ankesat në të ardhmen, duke bërë që vetëm ato organizata që kanë një mbështetje të posaçme për të ndjekur këto çështje të jenë të motivuara për të ndjekur rrugët e ankimit, kurse të tjerat, dhe sidomos individë nga grupet e interesit, të mos marrin mundimin të vepronë.

Një situatë e ngjashme ka rezultuar me ligjin nr. 8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit mbi dokumentat zyrtare”, i cili qendroi në fuqi për 15 vjet dhe nuk përdorej nga publiku. Nismat për të ndryshuar këtë ligj kundërshtoheshin nga ligjvënësi me justifikimin se ligji nuk kritikohet nga një masë e madhe e publikut, duke nënvlehtësuar faktin që ai ligj nuk kritikohej sepse nuk përdorej. Kjo është edhe kritika më e rëndë që mund t’i bëhet një ligji, që ai të perceptohet si i papërdorshëm.

7. Konkluzione të monitorimit

Megjithëse ligji ka rreth 2 vjet që ka hyrë në fuqi, ai nuk po zbatohet nga organet publike, si dhe nuk shërben si një mjet efektiv për qytetarët.

Faqja zyrtare e Regjistrat Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik është një faqe jofunksionale. Ajo thjesht është ngritur si faqe

por asnjë nga autoritetet publike nuk po zbaton detyrimet ligjore për të publikuar në këtë Regjistër projektaktet që ka hartuar. Nuk është e qartë nëse mungon vullneti i autoriteteve për të publikuar projektaktet në Regjistër, apo kjo faqe interneti është ende jofunksionale për probleme teknike. Për shumë kohë faqja ka qenë në ndërtim dhe në fazë testimi. Nisur nga fakti që vetëm 10% e autoriteteve publike të monitoruara kanë caktuar koordinator, është e qartë që numri i personave që mund të aksesojnë këtë faqe është i vogël. Në disa raste koordinatorët janë caktuar nga autoritete që nuk prodhojnë zakonisht akte të tillë që i nënshtrohen konsultimit publik, për shembull ADISA (Agjencia e Shërbimeve Publike të Integruara).

Autoritetet publike, jo vetëm që nuk publikojnë projektaktet në Regjistër, por më pak se gjysma e tyre kanë publikuar në faqet e tyre zyrtare projektakte për t’iu nënshtroar konsultimit publik dhe vetëm 1/4 kanë një rubrikë të veçantë për njoftimin dhe konsultimin publik.

Nga ana tjetër, edhe qytetarët nuk rezultojnë që po e përdorin këtë ligj, kjo për shkak edhe të faktit që ligji është shumë evaziv, pasi nuk parashikon mekanizma konkretë në rastin e refuzimit të autoriteteve për të zbatuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj. Si rrjedhojë, numri i ankesave për cenimin e të drejtës për t’u përfshirë në proceset konsultuese është shumë i ulët.

Të vetmet ankesa deri më sot janë ato të dorëzuara nga organizata të shoqërisë civile, si qendra Res Publica, të cilat kanë pasur si synim kryesor testimin e ligjit. Në të njëjtin konkluzion ka dalë edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit, i cili shprehet se:

“Vazhdon të jetë e ulët ndjeshmëria dhe angazhimi qytetar shprehur nga numri i pakët i ankesave sa i përket zbatimit të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Janë trajtuar 2 ankesa, në të cilat ankuesit kanë pretenduar në mos konsultimin e projekteve

me publikun. Një ankesë i referohej miratimit të projekt ligjit “Për Amnistinë” dhe projekt ligjit “Për të Drejtën e Autorit”.

Res Publica, në studimin e saj “Konsultimi Publik - Sfidat e para të zbatimit të ligjit”, publikuar në Qershor 2016, ka dhënë disa rekomandime, të cilat nuk janë marrë ende parasysh nga autoritetet relevante me qëllim përmirësimin e ligjit dhe kthimin e tij në një mjet efektiv në duart e qytetarëve.

TEKSTI I PLOTË I LIGJIT NR. 146/2014 “PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK”

LIGJ Nr. 146/2014 PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

1. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.

2. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.
3. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Akt administrativ individual” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.
2. “Akt nënligjor normativ” është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, që rregullon marrëdhënie të përcaktuara me ligj, duke vendosur rregulla të përgjithshme sjelljeje dhe që nuk shteron me zbatimin e tij.
3. “Emergjencë civile” është një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.
4. “Grup interesi” është çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara për projektaktet që i nënshtrohen procesit të konsultimit publik.
5. “Konsultim publik” është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e

projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

6. “Ministër përgjegjës” është ministri që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit.

7. “Njoftim paraprak” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e dhënies së informacioneve ose opinioneve paraprake, përpara fillimit të hartimit të projektaktit.

8. “Njoftim publik” është ftesa zyrtare për të marrë pjesë në procesin e konsultimit të projektaktit të propozuar dhe nisja e procedurave të konsultimit publik.

9. “Organ publik” është çdo organ i pushtetit qendror, i cili kryen funksione administrative, çdo organ i enteve publike, në masën që ato kryejnë funksione administrative, çdo organ i pushtetit vendor, që kryen funksione administrative, çdo organ i Forcave të Armatosura e çdo strukturë tjetër, për aq kohë sa këto kryejnë funksione administrative, si dhe çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

10. “Proces i vendimmarrjes” është proces që përfshin proceset e hartimit e të miratimit nga organet publike të projektakteve.

11. “Projektakt” është projekti i një ligji, projekte të dokumenteve strategjike, kombëtare dhe vendore, të politikave me interes të lartë publik, të hartuara nga organet publike.

12. “Regjistri elektronik” është faqja zyrtare e internetit ku do të publikohen projektaktet, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji.

13. “Rekomandim” është çdo sugjerim, propozim apo mendim me karakter konsultativ për projektaktet e hartuara, i shprehur verbalisht dhe/ose me shkrim nga palët e interesuara.

14. “Takim publik” është çdo takim i hapur me palët e interesuara për diskutimin e projektakteve që i nënshtrohen procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, me qëllim sqarimin dhe informimin e opinionit publik në lidhje me këto projektakte, si dhe marrjen e komenteve e të rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e tyre.

15. “Transparencë” është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Neni 3

Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse.

Neni 4

Kufizime

Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen gjatë procesit të vendimmarrjes që lidhet me:

- a) çështjet e sigurisë kombëtare, për aq sa ato përbëjnë sekret shtetëror, sipas ligjit për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”;
- b) marrëdhëniet ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe;
- c) aktet administrative individuale dhe aktet administrative me karakter normativ, përveçse kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe;
- ç) aktet normative, me fuqinë e ligjit, të miratuara në Këshillin e Ministrave;

d) emergjencën civile;

dh) çështjet e tjera përjashtimore të parashikuara me ligj.

Neni 5

Parimet në procesin e njoftimit e të konsultimit publik

Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik kryhet në bazë të parimeve të mëposhtme:

- a) transparenca gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- b) efektshmëria e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
- c) përgjegjësia e organeve publike ndaj palëve të interesuara.

KREU II

DETYRIMI PËR NJOFTIM DHE KONSULTIM PUBLIK

Neni 6

Detyrimi për njoftimin dhe konsultimin publik

1. Organet publike janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që të krijojnë mundësi për pjesëmarrjen e publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë:

- a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve;
- b) publikimin në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji;

c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

2. Organi publik, pas publikimit të njoftimit në regjistrin elektronik, mund të organizojë konsultime të drejtpërdrejta dhe takime publike me palët e interesuara. Konsultimet e drejtpërdrejta dhe takimet publike me palët e interesuara dokumentohen me procesverbal. Procesverbali i takimeve publike, të organizuara sipas këtij ligji, është dokument zyrtar. Për konsultime veçanërisht të rëndësishme, si dhe kurdo që është e mundur, me vendim të organit publik, takimet publike transmetohen në median audiovizive publike për të mundësuar ndjekjen e tyre nga publiku i gjerë.

3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikave 1 dhe 2, të këtij neni, organet publike nuk përjashtohen nga detyrimi për publikimin dhe konsultimin e projekteve, sipas ligjeve të veçanta për funksionimin e tyre.

Neni 7

Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

1. Çdo projektakt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupe të caktuara.

2. Krijimi dhe rregullat e administrimit të regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

KREU III

PALËT E PËRFSHIRA NË KONSULTIMIN PUBLIK

Neni 8

Palët e interesuara

1. Palët e interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik janë:

- a) organet publike;
- b) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit;
- c) personat fizikë të huaj me vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, si dhe personat juridikë të huaj, të regjistruar në Republikën e Shqipërisë.

2. Personat e tjerë të huaj mund të marrin pjesë në procesin e konsultimit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ose me kërkesë të drejtpërdrejtë të organeve publike, kur e çmojnë të nevojshme.

Neni 9

Të drejtat e palëve të interesuara

Palët e interesuara në procesin e njoftimit dhe konsultimit publik kanë të drejtë:

- a) të kërkojnë informacion për procesin e njoftimit e të konsultimit publik, përfshirë aksesin në projektakt, sipas përcaktimit të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji;
- b) t’u propozojnë organeve publike fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e projektakteve, sipas planit vjetor të procesit të vendimmarrjes, publikuar nga organi publik, në përputhje me parashikimet e shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji;

c) t’u dorëzojnë organeve publike komente dhe rekomandime për projektaktet që janë në proces të njoftimit e të konsultimit publik.

Neni 10

Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik

Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ky ligj.

KREU IV

RREGULLAT E PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Neni 11

Mënyrat e njoftimit dhe marrja e komenteve dhe rekomandimeve

1. Njoftimi për projektaktet që do t’i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet regjistrit elektronik. Në rastet kur organi publik e konsideron të nevojshme, njoftimi mund të kryhet edhe në një apo disa nga format e mëposhtme:

a) me postë elektronike;

b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik inicues;

c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;

ç) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetatat më të lexuara në nivel kombëtar.

2. Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në

raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike.

Neni 12

Njoftimet paraprake

1. Organi publik, në raste të veçanta, mund të mbledhë informacione dhe/ose opinione paraprake nga grupet e interesit përpara se të nisë procesin e hartimit të aktit përkatës.
2. Në fazat fillestare, organi publik, kur e gjykon të nevojshme, publikon në një nga format e parashikuara në nenin 11 një njoftim paraprak për aktin që do të hartojë për të siguruar informacione nga palët e interesuara.
3. Çdo palë e interesuar mund t'i përgjigjet njoftimit paraprak brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, duke dorëzuar komente dhe rekomandime.

Neni 13

Përmbajtja e njoftimit në lidhje me nismën vendimmarrëse

1. Në njoftimin për fillimin e procesit të konsultimit publik duhet të përcaktohen të paktën:
 - a) arsyet e nevojshme për nxjerrjen e projektaktit, si dhe ndikimi që ai do të ketë;
 - b) afati, vendi dhe mënyra me të cilën palët e interesuara paraqesin ose dërgojnë rekomandimet e tyre;
 - c) adresa e kontaktit të koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik të organit publik për mbledhjen e rekomandimeve e të komenteve për projektaktin;
 - ç) vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij.

2. Aksesit në dokumentacionin e nevojshëm që lidhet me projektaktin sigurohet edhe sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit.

Neni 14

Informacioni që nevojitet të sigurohet

1. Palët e interesuara që do të konsultohen, pajisen me informacionin e nevojshëm për t'u krijuar atyre mundësinë të kontribuojnë në mënyrën më efektive të mundshme në procesin e përgatitjes së projektaktit në rrugë elektronike dhe/ose postale.

2. Krahas dokumenteve përkatëse, në varësi të kompleksitetit, volumit dhe karakteristikave të tjera të projektaktit, sigurohen shpjegime për qëllimin, problemet që do të trajtohen, idetë e përgjithshme, ndryshimet kryesore dhe/ose alternativat e mundshme dhe, për aq sa është e mundur, studime apo analiza që janë kryer për hartimin e projektaktit.

Neni 15

Afati për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve

1. Palëve të interesuara u jepet koha e arsyeshme për të dërguar pranë organit publik vendimmarrës komentet dhe rekomandimet e tyre:

a) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak;

b) brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

2. Për akte veçanërisht komplekse ose të rëndësishme, sipas vendimit të organit publik, afati për dërgimin e komenteve mund të zgjatet deri në 40 ditë pune nga data e njoftimit.

3. Përcaktimet e sipërpërmendura nuk anashkalojnë afatet kohore

të përcaktuara në ligje të veçanta për procedurat e konsultimit dhe informimit publik.

Neni 16

Zgjatja dhe përsëritja e fazës së konsultimit

Organi publik mund të zgjasë afatin për dërgimin e komenteve ose mund të ripërsëritë fazën e marrjes së komenteve e të rekomandimeve në rastet kur:

- a) organi publik nuk është i kënaqur me cilësinë e komenteve të përftuara;
- b) në komentet dhe rekomandimet e dhëna janë ngritur çështje të reja të rëndësishme që nuk kanë qenë pjesë e konsultimit fillestar.

Neni 17

Njoftimi për takime publike

1. Gjatë periudhës së konsultimit, nisur nga rëndësia e projektaktit dhe interesi i lartë publik, organi publik mund të organizojë takime publike, ku palët e interesuara paraqesin opinionin e tyre dhe të dhëna për projektaktin që do të hartohet.
2. Palëve të interesuara, të ftuara për të marrë pjesë në takimet publike, u jepet koha e nevojshme për përgatitje. Në çdo rast, ato informohen jo më pak se 20 ditë pune përpara takimit publik, duke u vënë në dispozicion kopje të projektaktit që do të diskutohet.

Neni 18

Pjesëmarrja në takimet publike

1. Konsultimi në takime publike është i hapur.
2. Njoftimi për organizimin e takimeve publike bëhet sipas mënyrave të njoftimit, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

3. Përfaqësuesi i organit publik, që drejton takimin, në përputhje me rregullat e organit publik, u ofron pjesëmarrësve mundësinë për të shprehur mendimin e tyre për çështjet që diskutohen.
4. Në çdo takim publik mbahet procesverbal, i cili arkivohet pranë organit publik.
5. Nëse konsiderohet e nevojshme, takimi publik mund të regjistrohet.
6. Procesverbalet dhe regjistrimet e takimeve publike mund të bëhen publike sipas kërkesës së paraqitur, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare.

Neni 19

Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve

1. Komentet dhe rekomandimet e marra gjatë procesit të konsultimit publik grumbullohen nga koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik të organit publik përkatës në një mënyrë të strukturuar dhe transparente.
2. Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve kryhet nga organi publik përgjegjës për hartimin e projektaktit, i cili vendos për pranimin ose refuzimin e rekomandimeve të marra nga palët e interesuara të konsultuara.
3. Projektaktet shoqërohen me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuar, sipas dispozitave të këtij ligji. Nëse rekomandimet e palëve të interesuara nuk janë pranuar, atëherë organi publik paraqet një përmbledhje të arsyeve për mospranimin e tyre në një nga format e njoftimit, të parashikuar në nenin 11 të këtij ligji.

Neni 20

Raportet për transparencën në procesin e vendimmarrjes

1. Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë

raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- a) numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- b) numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- c) numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- ç) numrin e takimeve publike të organizuara.

2. Raporti vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes publikohet sipas parashikimeve të nenit 11 të këtij ligji.

KREU V

KOMPETENCAT DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

Neni 21

Procedurat për shqyrtimin e ankesave

1. Nëse palët e interesuara vlerësojnë se organi publik ka cenuar të drejtën e tyre për njoftim dhe konsultim publik, sipas parashikimeve të pikës 1, të nenit 6, të këtij ligji, si dhe kur nuk janë respektuar afatet e parashikuara në nenet 15 dhe 17 të këtij ligji, mund të ankohen:

- a) pranë titullarit të organit publik përgjegjës për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, kur projektakti nuk është miratuar ende;
- b) pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.

2. Organi publik përgjegjës, me marrjen e ankesës, merr masa

të menjëhershme për korrigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura në ankesën e palës së interesuar.

Në çdo rast, autoriteti publik njofton palën e interesuar për masat e marra dhe e fton të jape komentet dhe rekomandimet për projektaktin.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me marrjen e një ankese, i kërkon ankuesit dhe organit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 10 ditëve. Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri organizon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.

4. Në përfundim të shqyrtimit, Komisioneri, kur arrin në përfundimin që ka shkelje të dispozitave të këtij ligji, i propozon organit publik përgjegjës marrjen e masave administrative ndaj personit/personave përgjegjës, sipas legjislacionit për shërbimin civil në fuqi.

KREU VI

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 22

Dispozita përfundimtare

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

* * *

VKM NR. 828/2015 PËR REGJISTRIN ELEKTRONIK PËR NJOFTIMIN & KONSULTIMIN PUBLIK

VENDIM

Nr. 828, datë 07.10.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË KRIJIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT ELEKTRONIK PËR NJOFTIMET DHE KONSULTIMET PUBLIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin, funksionimin, administrimin dhe monitorimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK)

dhe publikimin e tij në formën e një portali elektronik, faqeje web-i, me adresë elektronike: <http://www.konsultimi publik.gov.al>.

2. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike drejton procesin e krijimit, funksionimit, administrimit dhe monitorimit të vazhdueshëm të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

3. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike do të hostohet në serverat e Agjencisë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI).

4. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përfshin:

a) si të dhëna parësore, të gjitha njoftimet dhe projektaktet që publikohen për herë të parë në RENJK, siç përcaktohet në pikën 9, të këtij vendimi;

b) si të dhëna dytësore, të gjitha projektaktet që tërhiqen nga databaza e organit publik ku janë të publikuara për herë të parë sipas legjislacionit të posaçëm/sektorial të funksionimit të organit publik.

5. Të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, janë dhënë të informacionit për Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.

6. AKSHI, si autoritet rregullues e coordinator për bazat e të dhënave shtetërore, rast pas rasti, përcakton shkallën e ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave për publikimin e projektakteve.

7. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike ofron akses të hapur dhe pa pagesë për informim, printim dhe ripërdorim të dokumenteve të publikuara në të për të gjithë përdoruesit, grupet e interesit.

8. Të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, kanë akses në hedhjen dhe editimin e të dhënave respektive në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe mbajnë përgjegjësi për përmbajtjen e informacionit të publikuar prej tyre.

9. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike përmban në bazën e tij të të dhënave:

a) të gjitha projektdokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore, si dhe të politikave me interes të lartë publik;

b) të gjitha projektaktet, njoftimet për konsultim dhe të dhënat e lidhura me konsultimin e projekteve;

c) planet vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;

ç) informacionin në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat, duke filluar nga publikimi i projektaktit, marrja e komenteve dhe rekomandimeve për përmirësimin e tij, organizimi i debateve publike e deri te miratimi i aktit përfundimtar.

10. Të gjitha projektaktet në faqen web duhet të jenë të plota. Çdo projektakt duhet të publikohet si një dosje/file e veçantë në format elektronik të përshtatshëm, për t’u ruajtur, shkarkuar dhe ripërdorur sipas rregullores së miratuar nga AKSHI për të dhëna të hapura.

11. Çdo organ publik i ngarkuar për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për të grumbulluar, sistemuar, përshtatur dhe hedhur në formatin e duhur, në faqen e web-it, të gjitha projektaktet e iniciuara nga të gjitha strukturat dhe departamentet e institucionit përkatës, si edhe për të bërë përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit. Kjo detyrë duhet të përfshihet në përshkrimin e punës së personit të caktuar.

12. Personi i caktuar nga çdo organ publik ka detyrimin për të pasqyruar të dhënat e kërkuara në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, jo më vonë se 48 orë nga momenti i miratimit të dokumentit nga organi publik, përveçse kur me urdhër të organit public ose nisur nga natyra e informacionit, regjistrimi duhet të kryhet brenda një afati më të shkurtër.

13. Personi i caktuar nga çdo organ public duhet të pajiset nga administratori i Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike me emrin e përdoruesit “user name” dhe fjalëkalimin “password”, si dhe me manualët për hedhjen e të dhënave në sistem, operimin, përdorimin e faqes web etj.

14. Çdo organ publik, që përfshihet në hedhjen e projektakteve në <http://www.konsultimipublik.gov.al>, është përgjegjës për tërësinë dhe llojshmërinë e akteve të hedhura, cilësinë, integritetin, formatin dhe renditjen hierarkike dhe lidhjen e akteve ndërmjet tyre, vendosjen sipas fushës së veprimtarisë, institucionit etj.

15. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është përgjegjës për hostimin e Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike dhe garanton funksionimin në mënyrë të vazhdueshme të tij, mbrojtjen nga viruset dhe sulmet e ndryshme të kësaj faqeje dhe informacionit që gjendet në të, kryerjen periodike të back-up-it etj. AKSHI, sipas nevojave, përgjigjet dhe për zhvillimin periodik të RENJK-së.

16. Deri në krijimin dhe bërjen funksional të Regjistrit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, konsultimi sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, bëhet përmes faqes zyrtare të çdo institucioni.

17. Ngarkohen ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike, të gjitha organet publike të ngarkuara për zbatimin e ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, si dhe Agjencia

Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

* * *

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra “Res Publica”

Komentar i ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin
dhe konsultimin publik”

Tirana, Albania

Expo Vision Albania, 2017

124 p. ; 21x14.8cm

ISBN 978-9928-4337-3-2

347 .96(496.5)

www.respublica.org.al

www.publeaks.al